



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPATINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	155/13
Nr. i fq. / Br. st.	-34-
Data: / Datum	27.06.2013
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

**RR E GULL O R E
PËR SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE**

Vushtrri 2013

Bazuar në nenin 11, 12.2 shkronja c) dhe nenit 17 shkronja f) dhe shkronja p) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës se Kosovës", 28/2008) dhe të dispozitave të nenit 41.2 shkronja "c" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më: 27.06.2013, miratoi këtë:

RR E G U LL O R E PËR SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen të drejtat dhe detyrat e qytetarëve, kushtet minimale për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës në territorin e komunës, këshillave shtëpiak, vendbanimeve, ndërmarrjeve, enteve, institucioneve, organeve të administratës, organizatave politike, organizatave joqeveritare dhe subjekteve tjera.

Neni 2

Shërbimet publike komunale, në vështrim të kësaj rregulloreje konsiderohen:

- a) furnizimi me ujë;
- b) furnizimi me ngrohje;
- c) përcjellja dhe pastrimi i ujërave të zeza dhe atmosferike;
- d) rregullimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara publike;
- e) pastrimi i sipërfaqeve publike në vendbanime;
- f) bartja, deponimi dhe përpunimi i mbeturinave;
- g) mirëmbajtja dhe rregullimi i sipërfaqeve publike;
- h) rregullimi i transportit lokal, (e rregulluar me akt të veçantë);
- i) mirëmbajtja e ndriçimit publik;
- j) mirëmbajtja e varrezave, (e rregulluar me akt të veçantë);
- k) rregullimi dhe mirëmbajtja e objekteve sportive.

Neni 3

Objekte komunale-publike në vështrim të kësaj rregulloreje konsiderohen:

- a) rrjeti i tërësishëm i ujësjellësit dhe kanalizimit me të gjitha pajisjet;
- b) rrugët dhe trotuaret;
- c) sheshet;
- d) hapësirat për parking;
- e) sipërfaqet publike të gjelbëruara;
- f) terrenet sportive;
- g) varrezat;
- h) pajisjet për ndriçim publik;
- i) rrjeti i PTK - së dhe telefonat publik;
- j) nyjet sanitare publike;
- k) tabelat për shpallje;
- l) panot ndriçuese, reklamat;
- m) të gjitha objektet tjera të cilat sipas destinimit që kanë mund të konsiderohen objekte komunale dhe
- n) ndërtesarët shumëkatëshe, si dhe objektet e vjetra siç janë monumentet historike.

Neni 4

4.1. Të gjithë shfrytëzuesit e objekteve komunale janë të detyruar që ato t'i mirëmbajnë dhe t'i shfrytëzojnë në mënyrën e caktuar sipas kësaj Rregulloreje, duke pasur parasysh se pamja dhe gjendja e këtyre objekteve duhet të janë në funksion të pamjes sa më të bukur të qytetit.

4.2. Qytetarët, subjektet dhe të gjithë shfrytëzuesit e objekteve janë të detyruar të kujdesen për realizimin e mbrojtjes së objekteve, ashtu siç parashihet me këtë Rregullore.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Ujësjellësi dhe kanalizimi

Neni 5

5.1. Ndërmarrjet, detyrë e të cilave është furnizimi i qytetarëve me ujë të pijshëm në mënyrë të rregullt dhe përcjellja e ujërave të zeza dhe atmosferike bëjnë eksploatimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve nga neni 3 i kësaj rregulloreje e veçanërisht:

- a) bëjnë mirëmbajtjen dhe sigurimin e rregullt të të gjitha objekteve, pajisjeve dhe instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit;
 - b) bëjnë kontrollimin e përhershëm të cilësisë së ujit të pijshëm, për sigurimin e pandërprerë të rregullsisë higjenik - teknike të ujit të pijes, sipas dispozitave ligjore për këtë lëmi;
 - c) bëjnë ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve, pajisjeve dhe të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit;
 - d) jasin kushtet për sigurimin e lidhjeve në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, dhe
 - e) së paku dy herë në vit (në muajin prill dhe tetor) bëjnë pastrimin e të gjitha pusetave akumuluese dhe të pusetave për ujërat atmosferike dhe ujërave të zeza,
- 5.2. Ndërmarrjet (nga alineja 5.1. e këtij neni) për të gjitha objektet, si dhe instalimet e ujit dhe të kanalizimit, i mirëmbajnë në pajtim me këtë rregullore dhe ligjet në fuqi, duke qenë të detyruara që t'i mbajnë si mjete themelore të veta në shfrytëzim.

Neni 6

6.1. Mbikëqyrjen e cilësisë së ujit e bënë organi kompetent sanitari sipas dispozitave ligjore dhe i ndërmerr masat me të cilat sigurohet cilësia e kërkuar.

6.2. Vlerësimin për cilësinë e ujit e jep laboratori i vetë ndërmarrjes publike, të cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe i vërteton enti i autorizuar shëndetësor.

Neni 7

Të gjithë shfrytëzuesit e ujit të pijshëm nga "kaptazhet" më të vogla të pompave shpërndarëse në vendbanimet ku ekziston rrjeti qendror i ujësjellësit janë të detyruar që në afat prej një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi e kësaj rregulloreje të kyçen në këtë rrjet.

Neni 8

8.1. Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e obliguar që shfrytëzuesve t'u sigurojë rregullisht ujë të pijshëm.

8.2. Obligimet nga alineja paraprake pushojnë në këto raste:

- a) të veprimit të fuqisë madhore;
- b) të pengesave të jashtëzakonshme teknike të bëra pa fajin e ndërmarrjes nga alineja paraprake;
- c) gjatë punëve të rregullta ose të jashtëzakonshme për përmirësimin e nyjeve të ujësjellësit;

d) gjatë kryerjes së punëve të reja ose rikonstruktimit të pajisjeve të ujësjellësit.

8.4. Për të gjitha këto raste të furnizimit jo të rrugët me ujë, ndërmarrja të cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e obliguar që përmes mjeteve të informimit publik t'i njoftojë shfrytëzuesit mbi shkaqet dhe zgjatjen e ndërprerjes së ujit.

8.5. Me rastin e ndërprerjeve lokale të planifikuara (më parë) të furnizimit me ujë shfrytëzuesit duhet të njoftohen së paku 24 orë më herët me datën, kohën dhe zgjatjen e ndërprerjes.

Neni 9

9.1. Çdo objekt i cili do të jetë i furnizuar me ujë nga ujësjellësi publik i qytetit, duhet patjetër ta ketë lidhjen e veçantë të ujësjellësit.

9.2. Objektet nga alineja paraprake duhet të kenë rrjetin e veçantë të kanalizimeve.

9.3. Ngritjen e rrjeteve të reja dhe rikonstruktimin e atyre ekzistuese të ujësjellësit dhe të kanalizimit, investitori është i obliguar që t'i rregullojë ashtu që përveç ujësjellësve kryesor, njëkohësisht duhet t'i bëjë edhe lidhjet deri te linja e rregullacionit, por në bazë të planit urbanistik.

9.4. Këto punë duhet t'i kryejë ndërmarrja e autorizuar për këto çështje.

Neni 10

10.1. Ndërtimi i rrjeteve të reja nëpër rrugë në të cilat ekziston përcjellësit kryesor të ujësjellësit dhe të kanalizimit, me kërkesën e investuesit i kryen, kryesisht, ndërmarrja së cilës i janë besuar punët për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, ose në mbikëqyrje të saj.

10.2. Ndërmarrja nga alineja paraprake obligohet që gjatë ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit t'u përbahet dispozitave sanitare-teknike mbi vënien e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit. Ndërmarrja nga alineja 10.1 e këtij nenit është përgjegjëse për cilësinë e të gjitha llojeve të punëve rrëth lidhjes me rrjetin gjegjës.

Neni 11

11.1. Instalimet e ujësjellësit dhe të kanalizimit lidhen në ujësjellës dhe kanalizim, me anë të pajisjeve të rrjetit. Vënia e nyjeve përcjellëse nënkuption bashkimin e rrjetit publik të ujësjellësit deri te ujëmatësi, respektivisht prej rrjetit rrugor deri te linja e regullacionit.

11.2. Ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit do të mirëmbajë rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, bashkë me nyjet përcjellëse të ujëmatësit, respektivisht deri te objekti i parë akumulues i pusetës.

11.3. Ndërmarrja nga alineja paraprake është e obliguar që ta mirëmbajë në gjendje të rrugët edhe ventilin e parë të ujëmatësit.

Neni 12

12.1. Çdo objekt i cili kufizohet me rrugët ose sheshin ku është ngritur rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit duhet të lidhen me rrjetin e ujësjellësit e të kanalizimit përmes nyjeve përcjellëse.

12.2. Pronarët e hidroforëve dhe ata të cilët furnizohen me ujë në mënyrë jo adekuate, si dhe pronarët e nyjeve sanitare me gropë septicë dhe fushore janë të obliguar që në rrugët ku ekziston rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit të ndërlidhen me ato menjëherë, e më së voni në afatin prej dy muajsh, pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 13

13.1. Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit i jep shënimet për përpunimin e dokumentacionit teknik të instalimit dhe të kanalizimit si dhe të nyjeve përcjellëse.

13.2. Nyjet përcjellëse mund të ngriten në bazë të lejes pér ndërtim.

13.3. Leja nga alineja paraprake lëshohet në bazë të dokumentacionit teknik pér objekte të cilat janë ndërtuar.

Neni 14

14.1. Lejen pér nyjen përcjellëse në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit e lëshon ndërmarrja së cilës i janë besuar punët.

14.2. Lejen pér rrëmihjen e rrugëve, trotuareve dhe të sipërfaqeve publike, lidhur me vënien e nyjeve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit e jep organi kompetent – DSHP-ja.

Neni 15

15.1. Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit është e detyruar që ta ndërlidhë ujësjellësin dhe kanalizimin rrugor me pajisjet shtëpiake të ujësjellësit dhe të kanalizimit, nëse këto janë kryer me projektin e lejuar dhe sipas dispozitave dhe kushteve teknike, në afat prej 10 ditësh nga dita e njofitimit se punët përgatitore pér lidhje janë kryer(përfunduar).

15.2. Nëse ndërmarrja nga alineja paraprake nuk e kryen lidhjen me kërkesën e palës, atëherë Drejtoria pér Shërbime Publike, këto punë mund t'ia besoj individit tjetër juridik ose fizik të autorizuar pér kryerjen e këtyre punëve me shpenzime te marrësit të shërbimeve.

Neni 16

Shpenzimet pér ndërtimin e lidhjeve dhe shpenzimet e lidhjeve me rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit i bartin shfrytëzuesit e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit.

Neni 17

Ndalohet lidhja pa leje në rrjetin publik të ujësjellësit dhe të kanalizimit.

Neni 18

Lidhja në rrjetin publik të ujësjellësit, shfrytëzimi dhe matja e ujit të shpenzuar duhet patjetër të kryhet vetëm përmes ujëmatësve. Në rast të prishjes së ujëmatësve ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së tyre do të caktojë shumën e paragjykuar (paushall) të pagesës së mesatares së tre muajorit të fundit, deri të bëhet rregullimi i ujëmatësit.

Neni 19

19.1. Pronarët e objekteve me rrjet të ujësjellësit në të cilin shpenzimet e ujit paguhen në mënyrë të paragjykuar, janë të obliguar që në afatin prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje(me shpenzimet e veta) ta vendosin ujëmatësin në rrjetin e vet.

19.2. Nëse shfrytëzuesi i ri i ujëmatësit nuk e vendos ujëmatësin, ndërmarrja e autorizuar menjëherë do ta shkyc shfrytëzuesin e ri nga ujësjellësi publik dhe do të kërkojë dëmshpërblimin.

Neni 20

20.1. Vendosjen (respektivisht montimin) e ujëmatësve dhe ndërrimin e tyre e bënë ekskluzivisht ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe në afat prej 45 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës nga ana e pronarit.

20.2. Vendosja e ujëmatësve të rinj, riparimi dhe ndërrimi i ujëmatësve të vjetër bëhet me shpenzimet e shfrytëzuesve të ujëmatësve.

Neni 21

Ujëmatësit patjetër duhet të jenë të mbrojtur dhe të vendosur në vendet e veçanta dhe të mbyllura, të cilat ndërtohen me shpenzimet e investitorit, respektivisht të pronarit të objektit në bazë të udhëzimeve të ndërmarrjes të cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit.

Neni 22

Çdo prishje dhe dëmtim të ujëmatësve, konsumatori është i obliguar që menjëherë ta paraqes te ndërmarrja të cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe kjo është e detyruar që këtë prishje dhe dëmtim ta sanojë në afatin prej 24 orësh.

Neni 23

Shpenzimet e mirëmbajtjes së kyçësve të ujësjellësit(prej lidhjes me rrjetin e jashtëm të ujësjellësit deri te ujëmatësi) i heq ndërmarrja të cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, kurse shpenzimet tjera i heq konsumatori.

Neni 24

Konsumatorët dhe shfrytëzuesit e ujësjellësit publik janë të detyruar që me kohë të ndërmarrin masa që instalimet e shtëpive të mbrohen nga prishjet, ngricat dhe të mbahen gjithnjë në gjendje të rregullt.

Neni 25

Ndreqjen e ujëmatësit duhet ta bëjë vetëm ndërmarrja e autorizuar, të cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit.

Neni 26

- 26.1. Shpenzimi i ujit paguhet sipas tarifës pér 1 m^3 ujë.
- 26.2. Sasia e ujit të shpenzuar vërtetohet me anë të ujëmatësit.

Neni 27

27.1. Pér shfrytëzimin e ujit dhe të shërbimeve nga rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit paguhet kompensimi nga ana e konsumatorëve pér ndërmarrjen e ujësjellësit dhe kanalizimit.

27.2. Tarifën mbi lartësinë e këtij kompensimi e cakton Zyra e Rregulatorit të Ujit dhe Mbeturinave (ZRRUM), nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 28

- 28.1. Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit do t'i shkyç shfrytëzuesit e ujit nga ujësjellësi publik në këto raste:
 - a) kur fatura pér ujin e shpenzuar nuk paguhet në afat prej 15 ditësh pas marrjes së vërejtjes me shkrim lidhur me mospagesën e ujit të shpenzuar;
 - b) kur konsumatori paraqet shpërnguljen, ndërsa konsumatori i ri nuk e paraqet ujin e shpenzuar;
 - c) kur meremetimi, pengesat dhe dëmtimet bëhen në rrjetin e ujësjellësit;
 - d) kur instalimi i ujësjellësit i dëmon ton shfrytëzuesit e vet, përkatesisht cilësia e ujit në rrjetin e ujësjellësit nuk është e mirë;
 - e) nëse gropë e ujësjellësit (vendi ku është bërë lidhja-ujëmatësi) është e ndotur, e mbyllur ose e prishur, ndërsa konsumatori (edhe pse i është bërë vërejtja me shkrim nga ndërmarrja) nuk ka ndërmarr veprime pér eliminimin e të metave;
 - f) kur dëmtohet apo hiqet blomba nga ujëmatësi dhe;
 - g) kur vet pronari e rregullon ujëmatësin.

28.2. Kyçja e sérishme bëhet me kompensimin e shpenzimeve të kyçjes nga pronari.

Neni 29

Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit nuk do të kërkojë kompensim për ujin e shpenzuar nga hidrantët publike që harxhohen për fikjen e zjarreve.

Neni 30

Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit është e obliguar që ta pengojë çdo derdhje të ujit pa arsyé.

Neni 31

31.1. Në raste të thatësisë dhe pengesave tjera të furnizimit me ujin e pijes, ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit është e obliguar që të ndërmerr masa teknike të kufizimit të shpenzimit të ujit.

31.2. Në këto raste ndërmarrja nga alineja paraprake do t'i propozojë organeve përkatëse të administratës komunale të Vushtrisë që me urdhëresë të veçantë të caktojë mënyrën e shpenzimit të ujit, kufizimit ose ndalimin e shpenzimit të ujit, për disa konsumatorë të caktuar.

31.3. Urdhëresën e zbaton ndërmarrja dhe inspeksioni i komunës.

Neni 32

32.1. Përmes hidranave të rrjetit të ujësjellësit publik, ujin mund ta marrin vetëm ndërmarrjet dhe subjektet tjera, të cilat për këtë e kanë pëlqimin paraprak nga ndërmarrja të cilës i janë besuar punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit në koordinim me DSHP-në.

32.2. Shërbimi publik i zjarrfikësve ka të drejtë të marrë ujin nga ujësjellësi publik gjatë intervenimit në fikjen e zjarreve.

32.3. Të gjithë konsumuesit tjerë të ndërmarrjeve apo personat fizik të cilët marrin sasi të caktuara të ujit për kryerjen e ndonjë pune ndërtimore e të ngjashme, duhet patjetër të kenë leje të posaçme nga ndërmarrja (së cilës i janë besuar punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit).

32.4. Shfrytëzimi i ujit nga rrjeti i hidrantëve publik irregullohet me kontratë të posaçme ndërmjet ndërmarrjes dhe shfrytëzuesit.

Neni 33

Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së ujësjellësit dhe të kanalizimit është e detyruar që rregullisht ta mirëmbajë dhe ta bëjë pastrimin e përcjellësve dhe të pusetave për kanalizimin e ujérave fekale në mënyrë që në çdo kohë t'i përgjigjet destinimit të tyre.

Neni 34

34.1. Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët për mirëmbajtjen e ujësjellësit dhe të kanalizimit është e obliguar që pas punëve të kryera ndërtimore në kyçje, terrenin (vendin e punimeve) ta rikthejë në gjendje të rregullt siç ka qenë më parë.

34.2. Obligimi nga alineja e mëparshme bie në barrë të shfrytëzuesit respektivisht të investuesit, nëse këto punë i kryen vet (ku përfshihet rrëmihja dhe mbulimi i vendit ku është kryer lidhja).

Neni 35

Kryesit e punëve (personat juridik dhe fizik) janë të detyruar që materialin e tepërt ta mënjanojnë nga rrugët, trotuaret, sipërfaqet publike dhe terrenin ta kthejnë në gjendjen e mëparshme, menjëherë pas kryerjes së punëve, në afatin të cilin e ka caktuar organi kompetent me rastin e dhënisë së lejes për kyçje.

Neni 36

Gjatë shfrytëzimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit ndalohet:

- 36.1. Që në kanalet shtëpive, banesave, lokaleve, garazheve e të ngjashme si dhe në oborre të hedhen mbeturinat, hiri; çimentoja, rëra e fundërrinat tjera të ngjashme të cilat mund të shkaktojnë prishjen dhe dëmtimin e funksionimit të rregullt të pajisjeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- 36.2. Në përcjellësit e ujit të rrugëve të derdhen lëndët e ngurta e materiali tjetër;
- 36.3. Që në ujëmbledhës të hedhen mbeturinat nga pastrimi i oborreve dhe shesheve;
- 36.4. Derdhja në kanalizim e ujit dhe lëngjeve të tjera, temperatura e të cilave është më e lartë se 350 C ose me përbajtje të thartirave të dëmshme të alkaleve dhe të kripérave;
- 36.5. Derdhja e ujërave fundrrinore pa lejen e ndërmarrjes së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- 36.6. Në kanal të hedhet material ndezës i cili mund të shkaktoj zjarr;
- 36.7. Parkimi i automjeteve apo vënia e materialit ose mbeturinave në dhe mbi objektet e ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- 36.8. Të bëhet çfarëdo dëmtimi në objektet e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Gjelbërimi publik

Neni 37

37.1. Me qëllim të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra dhe zgjerimit e kultivimit të këtyre sipërfaqeve në territorin e qytetit, vendbanimeve dhe fshatrave, ato në mbikëqyrje dhe në mbrojtje, në mënyrën si është përcaktuar me këtë rregullore parashihen:

- a) sipërfaqet publike të gjelbra: rendet e drurëve, gjelbërimi i ambientit në lagjet e banimit, gjelbërimi afér rrugëve të trafikut, pyjet e të ngjashme;
- b) pjesët mbrojtëse të lagjeve në qytet me rrëthinë dhe në paralagjet e qytetit, në vendet e banuara dhe në zonat industriale (pjesët mbrojtëse të gjelbërimit dhe të sipërfaqeve tjera ujore), përveç tokës mbrojtëse pyjore, e cila është pjesë përbërëse e sistemit për mbrojtje nga vërshimet;
- c) sipërfaqet e gjelbra të ndërmarrjeve, organizatave e subjekteve tjera;
- d) sipërfaqet e gjelbra me destinim të veçantë dhe të dobishëm (gjelbërimi rrëth varrezave, rrëth objekteve kulturore historike dhe objekteve tjera me rëndësi);
- e) sipërfaqet e gjelbra për sport dhe rekreacion (oborret e shkollave dhe ushtrimoret, terrenet sportive, qendrat, vendet për rekreacion e të ngjashme) dhe objekteve komunale;
- f) gjelbërimi i oborreve të shtëpive, të vendeve për vikend, hapësirave të kampeve, lokaliteteve turistike dhe shëtitoreve, dhe
- g) parqet, miniparqet, lulishtet dhe drunjë dekorativ.

37.2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk kanë të bëjnë me pyjet, tokën bujqësore dhe pjesët e natyrës për të cilat aplikohen dispozita të veçanta.

Neni 38

- 38.1. Gjelbërimi i sipërfaqeve në vendet e posa ndërtuara parashihet me projektet e ndërtimeve të reja dhe bëhet me anë të kontrollit profesional të organit kompetent komunal.
- 38.2. Zgjerimi dhe ngritja e sipërfaqeve të reja bëhet me anë të projektit mbi ndërtimin dhe rregullimin e sipërfaqeve të reja në harmoni me planin rregullues urban.

Neni 39

- 39.1. Projektet e të gjitha objekteve që do të ndërtohen në pjesën e Komunës në vete duhet të përfshijnë edhe planet dhe skicat e tokës për gjelbërim, të cilat sipas lokacioneve u takojnë atyre objekteve.
- 39.2. Projektet të cilat nuk i kanë planet - skicat për gjelbërim, do të konsiderohen si jo të plota dhe nuk mund të lejohen.
- 39.3. Nëse lejohet ndërtimi në kundërshtim me paragrin 1 dhe 2 të këtij nenit përgjegjësia bie mbi organin i cili e ka lëshuar lejen ndërtimore.

Neni 40

Të gjitha planet - skicat e gjelbërimit duhet të janë të harmonizuara me planin e gjelbërimit të Komunës, respektivisht me konceptet e planeve rregulluese urbane për të cilat duhet të kujdeset projektuesi respektivisht investuesi.

Neni 41

- 41.1. Punët në gjelbërimin e tërësishëm të lokacioneve, investuesit janë të detyruar t'i kryejnë para se të bëhet pranimi teknik i punëve ndërtimore dhe të punëve të tjera nëpër objekte investive.
- 41.2. Komisioni për pranimin teknik të objekteve është i detyruar që njëkohësisht të bëjë pranimin teknik i punëve të gjelbërimit.

Neni 42

Sipërfaqet e gjelbëruara në mënyrë jo të rregullt në tokën e urbanizuar ndërtimore, shfrytëzuesi do t'i gjelbëroj në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, më së voni në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 43

Para se ta bëjë gjelbërimin e sipërfaqeve të parapara me këtë rregullore, shfrytëzuesit e tokës janë të obliguar që të marrin pëlqimin e organit kompetent komunal.

Neni 44

- 44.1. Punët e gjelbërimit: si kultivimi i drunjve, mirëmbajtja dhe mbrojtja e sipërfaqes publike dhe sipërfaqeve tjera të gjelbra në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje i kryejnë pronarët dhe ndërmarrja së cilës i besohen këto punë.
- 44.2. Të drejtat dhe obligimet lidhur me kryerjen e punëve nga alineja paraprake do të rregullohen me kontratë.

Neni 45

Nëse shfrytëzuesit e tokës nuk e bëjnë gjelbërimin në afatin e caktuar, organi kompetent i komunës do ta urdhëroj ndërmarrjen e cila merret me këto punë, që ta bëjnë gjelbërimin me shpenzimet e shfrytëzuesit.

Neni 46

Shfrytëzimi i sipërfaqeve të gjelbra publike jashtë destinimeve të tyre themelore, mund të bëhet vetëm me pëlqimin/lejen e organit kompetent.

Neni 47

Ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së rregullt të gjelbërimit është e obliguar që nëpër parqe, sheshe dhe vende tjera të vendos dhe të mirëmbajë numrin e nevojshëm të shportave për mbeturina të imta dhe numrin e mjaftueshëm të ulëseve për pushim.

Neni 48

Vendosja e instalimeve nëntokësore (objekteve të ujësjellësit dhe të kanalizimit, elektro distribuimit dhe të rrjetit të PTK-së e të ngjashme) në sipërfaqet e gjelbërta bëhet në distancë prej 2 m nga fidanja ekzistuese por me lejen paraprake për gropim nga organi i kompetent komunal dhe me obligimin e investuesit që ta kthej në gjendjen e mëparshme sipas kushteve të përshkruara në leje dhe në projekt.

Neni 49

Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së gjelbërimit është e obliguar:

- a) që menjëherë t'i largoj degët e dëmtuara për shkak të ndikimit të kushteve natyrore atmosferike ose nga shkaktarët tjerë;
- b) që barin e kositur si dhe materialin e mbetur ta largoj nga sipërfaqet e gjelbëruara publike.

Neni 50

Degët e rritura të drunjve në sipërfaqet e gjelbra publike të cilat pengojnë kabllot ajrore (rrjetin elektrik, telefonit e të ngjashme) duhet të shkurtohen ose të evitojen vetëm nga ana e ndërmarrjes së cilës i besohen punët dhe e cila është e obliguar që këtë ta bëjë me kërkesën e organit kompetent komunal apo të pronareve të objekteve apo të hapësirave nëpër të cilat kalojnë kabllot e ndryshme me kompensimin nga pronari i kabllove.

Neni 51

Dëmet e bëra në sipërfaqe e gjelbëruara nga ana e personave juridik e fizik, me kërkesën e ndërmarrjes së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së gjelbërimit, do të vlerësohen nga ana e komisionit të cilën e emëron organi i administratës, kompetent për shërbimet komunale.

Neni 52

Ndërmarrjes së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së gjelbërimit është e obliguar që në vend të dukshëm do të vendos vërejtjet apo ndalesat të cilat kanë të bëjnë me këto sipërfaqe.

Neni 53

53.1. Në sipërfaqet e gjelbëruara publike ndalohet:

53.1.1. Këputja dhe shkulja e drunjve, barit dhe bimëve të tjera, thyerja e degëve apo fidaneve e të ngjashme;

53.1.2. Vozitja dhe parkimi i automjeteve (i të gjitha llojeve) si dhe shkarkimi dhe deponimi i çfarëdo materiali në këto sipërfaqe;

53.1.3. Dëmtimi i ulëseve, shportave, rekuizitave, kalimi për këmbësor, hidranave dhe instalimeve tjera;

53.1.4. Largimi, djegia, dëmtimi i shenjave dhe mbishkrimeve të vendosura me qëllim të mbajtjes së rendit;

53.1.5. Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike dhe të tjera të gjelbëruara jashtë destinimeve të tyre themelore ose kryerja e çfarëdo veprimtarie në to pa lejen e veçantë;

- 53.1.6. Vendosja dhe derdhja e çfarëdo lënde dhe materiali nëpër drunj dhe në pjesët tjera, pa lejen e organit kompetent për punët komunale;
- 53.1.7. Rrëzimi dhe zhvendosja ulëseve, rekuizitave sportive, rrrethojave e të ngjashme;
- 53.1.8. Shtrirja dhe qëndrimi nëpër sipërfaqe të gjelbëruara;
- 53.1.9. Lëvizja jashtë rrugicave të shënuara për këmbësor;
- 53.1.10. Lëshimi i ujérave të zeza nëpër parqe dhe sipërfaqe tjera publike;
- 53.1.11. Keqpérdorimi i ujit në fontana (hyrja në to, larja e personave dhe gjësendeve, turbullimi i ujit dhe hedhja e fundërrinave e mbeturinave tjera);
- 53.1.12. Gjuajtja e zogjeve dhe egërsirave jashtë vendeve dhe kohës së caktuar;
- 53.1.13. Kositja dhe largimi i barit nga sipërfaqet e gjelbëruara pa lejen e organit kompetent për punë komunale;
- 53.1.14. Vendosja e luna parkut, cirkut dhe rekuizitave tjera, pa lejen e organeve kompetente për punët komunale të administratës komunale;
- 53.1.15. Shfrytëzimi për kullosa të kafshëve dhe shpezëve shtëpiake;
- 53.1.16. Ndezja e zjarreve dhe djegia e gjethive;
- 53.1.17. Hedhja e shtazëve dhe shpezëve të ngordhura dhe fundërrinave të tjera;
- 53.1.18. Rrëmihja për çfarëdo destinimi pa marrë më parë lejen nga organi kompetent.
- 53.2. Përveç në sipërfaqet publike ndalohet edhe në sipërfaqe private:
- a) Shkarkimi dhe deponimi i çfarëdo materiali;
 - b) Lëshimi i ujérave të zeza;
 - c) Ndezja e zjarreve dhe gjësendeve tjera;
 - d) Hedhja e shtazëve dhe shpezëve të ngordhura dhe fundërrinave tjera.

Sipërfaqet publike

Neni 54

- 54.1. Sipërfaqet publike në kuptim me këtë Rregullore konsiderohen ato sipërfaqe në të cilat është i lejuar aderimi (qëndrimi) në numër të pakufizuar i personave si:
- 54.1.1. Sipërfaqet e trafikut publik (rrugët dhe sipërfaqet tjera për trafik, trotuaret, rrugicat dhe sipërfaqet tjera);
- 54.1.2. Stacionet e autobusëve, trenave nëse posedon qyteti, vendqëndrimet, stacionet e karburantit dhe hapësirat për parkim;
- 54.1.3. Sipërfaqet publike dhe të gjelbëruara, (parqet, sheshet e vogla, drunjtë, sipërfaqet me bar, sipërfaqet për pushim dhe rekreacion);
- 54.1.4. Terrenet argëtuese dhe sportive (stadiumet, fushat e sportit, çerdhet etj);
- 54.1.5. Sipërfaqet me ujë (plazhet afër lumit, pishinat) etj;
- 54.1.6. Tregjet, tregjet e gjelbëruara, për bylmet dhe për kafshë, vendet për grumbullimin e prodhimeve bujqësore dhe atyre qumështore dhe të kafshëve;
- 54.1.7. Sipërfaqet e hapura ndërmjet dhe rrëth banesave, si dhe tokat e pa ndërtuara (trojet, vendet për shkarkim dhe oborret e ndërtesave banesore);
- 54.1.8. Sallat e kinemave dhe të tjera të cilat shërbejnë për tubime publike të njerëzve;
- 54.1.9. Varrezat dhe hyrjet në varreza.

Rrugët dhe trotuaret

Neni 55

Rrugët janë sipërfaqe publike të cilat shërbejnë për qarkullimin e personave dhe të trafikut publik.

Neni 56

- 56.1.** Rrugët mbahen në gjendje të rregullt dhe shfrytëzohen në bazë të destinimit.
- 56.2.** Ndërmarrja e autorizuar për mirëmbajtjen e rrugëve lokale është e obliguar që të gjitha dëmtimet nëpër rrugët e trafikut dhe trotuare t'i evitojë si dhe t'i mbajë ato në gjendje të rregullt.

Neni 57

- 57.1.** Në sipërfaqet e rrugëve të shtruara me shtresën e asfaltit dhe me kubëza ndalohet lëvizja e të gjitha mjeteve transportuese dhe të tjera të cilat mund të dëmtojnë rrugën, siç janë: makinat me zinxhirë, llojet e ndryshme të makinave ndërtimore dhe mjetet tjera të ngjashme.
- 57.2.** Transporti i makinave dhe i mjeteve tjera që e dëmtojnë rrugën, mund të bëhet vetëm me mjete transportuese të veçantë. Po ashtu ndalohet qarkullimi i automjeteve me peshë mbi peshën e lejuar për ato rrugë.

Neni 58

- 58.1.** Trotuaret janë sipërfaqe publike të cilat shfrytëzohen për ecjen e këmbësorëve.
- 58.2.** Shiriti i rrugës shfrytëzohet për lëvizjen e mjeteve të komunikacionit.
- 58.3.** Sipërfaqet e tjera publike si: sheshet, sheshet e vogla, parqet dhe të ngjashme shfrytëzohen në bazë të destinimit të tyre.

Neni 59

Në sipërfaqet e trotuareve dhe të shesheve të vogla publike nuk lejohet parkimi i makinave, shitja dhe vendosja e gjësendeve për zhvillimin e ndonjë veprimtarie.

Neni 60

- 60.1.** Shkarkimi i mallit nëpër trotuare, bëhet vetëm atëherë kur kjo nuk mund të bëhet nëpër oborret e ndërtesave, respektivisht të hapësirave punuese.
- 60.2.** Njëkohësisht malli duhet të largohet menjëherë nga trotuari, e më së voni në afat prej një ore pas shkarkimit të mallit.
- 60.3.** Trotuaret dhe sheshet e vogla mund të shfrytëzohen për shkarkimin e mallit dhe të materialit për ngrohje vetëm me lejen paraprake të organit të administratës kompetente përrugë.

Neni 61

- 61.1.** Të gjithë personat fizik dhe juridik janë të obliguar që trotuaret, shiritat e rrugëve dhe sipërfaqet tjera publike t'i shfrytëzojnë në mënyrë si është rregulluar me këtë rregullore.
- 61.2.** Nëse gjatë shfrytëzimit të këtyre sipërfaqeve shkaktohet dëmtimi i tyre, shfrytëzuesit janë të obliguar që ato t'i kthejnë në gjendjen e mëparshme brenda 15-30 ditë me shpenzimet e veta.
- 61.3.** Vendosja në hapësira publike e objekteve të përkohshme nuk mund të bëhet pa u pajisur me leje nga DSHP-ja .
- 61.4.** Ndalohet hedhja e dheut, rërës, gurëve dhe materialit tjetër nëpër trotuare, sheshe të vogla, rrugë dhe sipërfaqe tjera të lira publike.

Neni 62

- 62.1.** Për ndërtimin e objekteve komunale, të ujësjellësit dhe të kanalizimit, të rrjetit elektrik dhe telefonit, mund të lejohet gropimi i shiritit të rrugëve dhe trotuareve.
- 62.2.** Gropimi i trotuareve dhe shiritit të rrugëve nga alineja paraprake duhet të bëhet me lejen e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

62.3. Rregullorja me të cilën lejohet gropimi i trotuareve dhe shiritit të rrugës dhe të sipërfaqeve publike, përvèç kushteve të tjera përmban edhe obligimin e shfrytëzuesve, respektivisht të investitorit që shiritin e rrugës dhe trotuarin, ta kthejnë brenda 15-30 ditë në gjendje të rregullt të mëparshme.

62.4. Pjesa e rrëmihur e rrugëve dhe trotuareve rimbushet vetëm me zhavorr e jo me dhe.

62.5. Organi i administratës kompetente për punët komunale para dhënes së lejes për gropimin e rrugëve shesheve të vogla dhe të sipërfaqeve tjera publike do të kërkojë, që investitori më parë ta paguaj taksën për gropim të paraparë me Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.

Ndriçimi publik

Neni 63

63.1. Të gjitha rrugët e qytetit, gjatë natës duhet të janë të ndriçuara:

63.1.1. Vendet e llambave elektrike për ndriçim publik duhet të janë të vendosura ashtu që mundësojnë ndriçimin e tërësishtëm të rrugëve, sipas normativave të përcaktuara.

63.1.2. Llambat e djegura patjetër zëvendësohen me të reja, brenda 24 orëve.

Neni 64

Për ndriçimin e rrugëve, ndërrimin e llambave të djegura dhe mirëmbajtjen e rrjetit ndriçues në gjendje të rregullt, do të kujdeset ndërmarrja të cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së ndriçimit publik.

Neni 65

Kryerjen e punëve në rrjetin publik elektrik dhe telefonik do ta bëjë vetë ndërmarrja e autorizuar dhe e specializuar për këto punë.

Neni 66

Ndalohet:

a) thyerja, djegia ose në mënyrë tjetër dëmtimi i instalimit elektrik publik, instalimeve elektrike, shtyllave, kabllave, rrjetit të telefonit, mjeteve izoluese, trafostacioneve etj.

b) ndalohet kryerja e punimeve në dhënen e lidhjeve për pajisjet shtëpiake, apo çfarëdo lidhje tjetër nga rrjeti i ndriçimit publik, shtyllave të instalimeve tjera, si dhe kontakti me to i personave të pa autorizuar.

Firmat dhe reklamat

Neni 67

67.1. Të gjithë organizatat biznesore janë të obliguar që ta vendosin firmën në hapësirën punuese dhe atë ta vendosin në pjesën e jashtme të hyrjes kryesore të lokalit, në të cilën veprojnë dhe punojnë.

67.2. Vënia e firmave, reklamave e të ngjashme nëpër muret e ndërtesave në hyrjet në rrugë dhe në qytet, nëpër parqe e në vende të ngjashme mund të bëhet vetëm me leje të Drejtorisë për Shërbime Publike.

Neni 68

Mbishkrimi i firmës duhet të jetë i shkruar lexueshëm. Mbishkrimet e firmave ndriçuese ose jo ndriçuese dhe reklamat mund të vendosen vetëm në bazë të lejes së dhënë nga ana e Drejtorisë për Shërbime Publike.

Neni 69

Mbishkrimet e firmave ndriçuese dhe reklamat, duhet të harmonizohen me dispozitat e kësaj rregulloreje në afat prej 3-6 muajsh pas miratimit të saj.

Neni 70

70.1. Pronarët e firmave me mbishkrime ndriçuese dhe të reklamave ndriçuese janë të obliguar që ti mbajnë ato në gjendje të rregullt.

70.2. Mbishkrimet e firmave ndriçuese duhet të janë të ndriçuara gjatë natës, prej momentit të ndezjes deri në momentin e fikjes së dritave të ndriçimit publik.

Neni 71

Në punishtet e objekteve në ndërtim e sipër të hapësirave punuese dhe në objektin i cili renovohet ose adaptohet si punues, duhet të vendosen mbishkrimet e firmave ndriçuese sipas dokumentacionit teknik të lejuar.

Neni 72

72.1. Pronarët, gjegjësisht shfrytëzuesit e hapësirave punuese janë të detyruar që mbishkrimet e firmave ndriçuese t'i mbajnë në gjendje të rregullt.

72.2. Në rast transferimi ose ndalimi të punës, pronarët e hapësirave punuese janë të obliguar që mbishkrimet e firmës ta heqin.

72.3. Kontrollin inspektues e bënë Drejtoria për Inspektime.

Neni 73

73.1. Tabelat, mbishkrimet e firmave, reklamat dhe të ngjashme mund të përpunohen nga qelqi, druri, llameria, llamarina dhe me material tjetër.

73.2. Format dhe madhësia e tyre duhet të janë në pajtim me formën dhe madhësinë e fasadës dhe të hyrjes në banesë, lokale, etj.

73.3. Ndalohet vënia e firmave varëse. Firmat ekzistuese varëse pa tjetër duhet të harmonizohen ose mënjanohen në afatin prej 60 ditësh prej ditës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

73.4. Kontrollin inspektuese e bënë Drejtoria e Inspeksionit – inspektori përkatës.

Neni 74

74.1. Nëse organi i administratës komunale kompetent për punët e inspepcionit vërteton se mbishkrimi i firmës nuk është vendosur ose nuk është në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, do të marrë vendim me të cilën do të obligohet organizata biznesore që mbishkrimin e firmës ta vendos në mënyrë si është e paraparë me rregullore.

74.2. Nëse shfrytëzuesi nuk vepron sipas Vendimit, vendosja e mbishkrimeve të firmave dhe largimin e mungesave të vërtetuara do ta bëjë organi kompetent dhe shpenzimet për këtë do t'i barte organizata biznesore.

Ndërtesat dhe pamja e jashtme e tyre

Neni 75

Pronarët e ndërtesave, shfrytëzuesit e ndërtesave janë të obliguar që personalisht ose me anë të ndërmarrjes së autorizuar për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës të ndërmarrin masa gjegjëse lidhur me pastrimin dhe mënjanimin e çfarëdo dëmtimi në linjën e ujësjellësit dhe kanalizimit në ndërtesë.

Neni 76

Nëse në ndërtesë për shkak të prishjes së kanalizimit derdhen ujërat e zeza dhe ujërat fundrrinore, në lokalet e përbashkëta e të ngjashme shfrytëzuesit-pronarët e lokaleve apo ndërtesave janë të obliguar që me shpenzimet e veta t'i eliminojnë prishjet në rrjetin e kanalizimit e të ujësjellësit.

Neni 77

77.1. Pamja e jashtme e ndërtesës (fasada, ballkoni, dyert, dritaret etj. pa marrë parasysh destinimin e tyre, shfrytëzimin apo pronësinë), pa tjetër duhet të mirëmbahet në pajtim me kërkesat estetike dhe pamjen e ndërtesës, ndërsa kushtet do t'i përcaktoj Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

77.2. Pronarët e ndërtesave dhe shfrytëzuesit janë të obliguar që fasadat dhe detajet e fasadave (ballkonet, terasat, zdrukthëtarit, ulluqet, tabelat dhe numrat e shtëpive e të ngjashme) të mirëmbahen, ngjyrosen, emaloohen dhe të përgatiten ashtu që gjithmonë të jenë në gjendje të rregullt dhe ta kenë pamjen estetike.

77.3. Për pastërtinë dhe rregullimin e objektit nga alineja paraprake janë të obliguar të kujdesen shfrytëzuesit e banesave dhe shfrytëzuesit e tjerë të hapësirave në pajtim me dispozitat e rendit shtëpiak dhe të ndërtesave banesore, ndërsa për rregullimin dhe pastërtinë e pjesëve të jashtme të ndërtesave tjera do të kujdesen shfrytëzuesit e hapësirave në ato ndërtesa ose ndërmarrja e cila drejton ndërtesën dhe pronarët e ndërtesës.

Neni 78

78.1. Oborret e ndërtesave dhe te lokaleve, duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të rregullt.

78.2. Për pastrimin e oborreve të ndërtesave banesore e punuese, kujdesen personat të cilët i shfrytëzojnë ndërtesat punuese dhe Këshilli i banuesve, ndërsa mbi pastrimin e oborreve rreth ndërtesave banesore dhe hapësirave punuese, kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave.

Neni 79

Pronarët e ndërtesave, respektivisht shfrytëzuesit e sipërfaqeve jo të ndërtuara, si dhe qiraxhinjtë e hapësirave afariste janë të obliguar që t'i pastrojnë ndërtesat dhe sipërfaqet rreth ndërtesave, respektivisht të sipërfaqeve jo të ndërtuara të cilat i shfrytëzojnë ata.

Neni 80

80.1. Ndalohet hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta: korridore, shkalle, ashensor etj.

80.2. Ndalohet lëshimi i ujit dhe te ngjashme për larjen e ballkoneve me qellim te pengimit te fqiut apo te tjerëve.

80.3. Ndalohet lëshuarja e tymit, çaxhes, avullit, kundërmimit të rendë, gazrave toksike etj, nga ndërtesat, lokalet punuese, tymtarët, gjeneratorët etj., në afërsi të ndërtesave banesore dhe afariste shumëkatëshe, veçanërisht në afërsi të, ballkoneve, fasadave, dritareve, terasave dhe hyrjeve në korridore e në shkallë.

Neni 81

81.1. Organi i administratës për punët e inspeksionit mundet që personave përgjegjës për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të rregullsise së pjesëve të ndërtesave, t'i urdhëroj me Vendim që t'i eliminojnë mungesat menjëherë apo ne afat te caktuar.

81.2. Nëse obliguesi nuk vepron sipas Vendimit, ndaj tij do te ushtrohet kërkesë kundërvajtëse.

Neni 82

- 82.1. Ndërtesat dhe objektet e tjera të cilat nuk mund të shërbejnë për destinimin e vet dhe japid një pamje jo të mirë, për arsy se janë vjetruar dhe mund të rrezikojnë ose paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, për trafik ose objektet fqinjë, duhet të rrënohen ose të mënjanohen.
- 82.2. Vendimin mbi rrënimin, respektivisht mënjanimin e merr inspektori komunal për punët e ndërtimit.
- 82.3. Nëse pronari, respektivisht organi qeverisës ose personi tjetër i autorizuar nuk e rrënon ndërtesën, respektivisht objektin tjetër në afatin e caktuar me vendim, rrënimin do ta bëjë Drejtoria për Inspekte, dhe shpenzimet për këtë ia faturon obliguesit sipas vendimit.

Vitrinat

Neni 83

Të gjithë shfrytëzuesit e ndërtesave të posa ndërtuara afariste ose të ndërtesave banesore me hapësirat afariste të cilat janë paraparë për shfrytëzim për nevojat vetjake ose për dhëni e tyre me qira, janë të obliguar që vitrinat para fillimit të përdorimit të bëhen në gjendjen e paraparë me projektin e ndërtesës.

Neni 84

- 84.1. Shfrytëzuesit e të gjitha hapësirave afariste në qytet dhe në paralagjet e qytetit janë të obliguar që vitrinat t'i rregullojnë në mënyrë estetike dhe profesionale.
- 84.2. Lëndët të cilat shërbejnë për ekspozim duhet të janë të pastërtë dhe të pa dëmtuara e çmimet e shkruara me material të njëjtë në të gjithë artikujt.
- 84.3. Nëpër vitrinat mund të vendosen reklamat e prodhimeve dhe shërbimet e shfrytëzuesve ose të ndërmarrjeve me të cilët shfrytëzuesi është në lidhje afariste.
- 84.4. Shfrytëzuesit e të gjitha hapësirave afariste dhe pronaret e tyre janë të obliguar që të vendosin orarin e kohës së punës (fillimi dhe mbarimin e kohës së punës).
- 84.5. Mbishkrimi vendoset në derën hyrëse të hapësirës afariste, shiores-lokalit dhe atë në pjesën e brendshme.

Neni 85

- 85.1. Shfrytëzuesit e hapësirave afariste janë të detyruar që vitrinat t'i mbajnë pastër dhe në gjendje të rregullt.
- 85.2. Në rast të zhvillimit të punëve në adaptimin, rikonstruksionin, regjistrimin e të ngjashme, vitrinat duhet të janë të mbuluara nga shikimi i kalimtarëve dhe atë në mënyrën më të përshtatshme.

Neni 86

- 86.1. Pronarët, respektivisht, shfrytëzuesit e ndërtesave afariste dhe të hapësirave afariste në qytet dhe në paralagjet e qytetit janë të obliguar që ti adaptojnë vitrinat e vjetruara të cilat e shëmtojnë pamjen e ndërtesës.
- 86.2. Inspeksioni komunal vërteton vjetërsinë e vitrinës dhe përcakton mënyrën e adaptimit të hapësirës afariste nga alineja paraprake respektivisht e obligon shfrytëzuesin e hapësirës në lidhje me adaptimin e vitrinës.
- 86.3. Lejen për adaptimin e vitrinës e lëshon Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
- 86.4. Vitrinat, zgarat etj. të nxjerra jashtë murit të lokalit, në trotuar e që i pengojnë kalimtarët në afat prej 1 muaji duhet të tërhiqen. Pas kalimit të kësaj date inspektori do të urdhëroj largimin me shkrim. Nëse prapë nuk tërhiqen do të nxjerr aktvendim për mbylljen

e lokalit dhe me shpenzime të pronarit ta angazhoj ndërmarrjen përkatëse për largimin e pengesës në trotuar-rrugë.

Rrethojat

Neni 87

Të gjitha rrrethojat në sipërfaqe publike pa marrë parasysh pronësinë, mund të ndërtohen vetëm në bazë të pëlqimit ne lokacion te organit kompetent.

Neni 88

88.1. Pronarët e rrrethojave të vjetra janë të detyruar që në afatin prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje ti mënjanojnë ato dhe në vend të tyre të vendosin rrrethojat e tipit të caktuar, sipas pëlqimit të organit të administratës.

88.2. Nëse ndërtimi i paraparë i rrrethojës së tipizuar, kërkon mjete më të mëdha materiale, organi i administratës kompetente për urbanizëm mundet përkohësisht të lejoj që në vend të rrrethojës së tipizuar të vihen rrrethojat prej druri të gjelbër, por që ato të mirëmbahen deri në vendosjen e tipit gjegjës të rrrethojës.

88.3. Të gjitha rrrethojat duke i përfshirë edhe rrrethojat e gjelbra duhet të mirëmbahen në gjendjen e cila nuk e prishë pamjen e përgjithshme të asaj pjese të qytetit.

Neni 89

Rrrethojat e gjelbra duhet të mirëmbahen ashtu që mos të kalojnë vijën e rregullacionit dhe të mos pengojnë trafikun publik. Deri te momenti i formimit përfundimtar të rrrethojës së gjelbër mund të shfrytëzohet si mbrojtëse rrrethoja ekzistuese.

Panot dhe tabelat e shpalljeve

Neni 90

90.1. Të gjitha llojet e shpalljeve, lajmërimeve, pllakateve, monitorëve reklamues elektronik, dhe reklamave të të gjitha llojeve, përveç vitrinave të teatrove dhe të kinemave, mundet të vendosen vetëm në vendet e caktuara (panot).

90.2. Drejtoria për urbanizëm në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike do të caktojë numrin e caktuar të vendeve për panot dhe tabelat e shpalljeve, me kërkesën e personave juridik - fizik.

90.3. Për mirëmbajtjen e panove dhe tabelave të shpalljeve do të kujdesen pronarët e tyre.

90.4. Për shpalljet më të vogla dhe lajmërimet për anëtarë të organizatave të ndryshme politike, kulturore, dhe organizatave sportive, mund të vendosen vitrinat e vogla ose tabelat e shpalljeve në vendet e përshtatshme në afërsi të hapësirave vepruese ose afariste të atyre organizatave.

90.5. Vitrinat qoftë edhe vitrinat e vogla nuk mund të vendosen nëpër fasada të hapësirave afariste, nëpër shtylla, ndërtesa banesore, si dhe vende tjera publike.

90.6. Ndalohet:

- Publikimi i të gjitha llojeve të shpalljeve, pllakatave, e të ngjashme, si dhe vendosja nëpër drunj dekorativ, rrrethoja të objekteve, mure dhe fasada, shtylla elektrike, shtepiza të transformatorëve, orman për pajisje të internetit, në shenjat e komunikacionit e të ngjashme;

- Për vendosjen e panove dhe të reklamave nga ana e organizatave dhe të qytetarëve nevojitet leja e organeve të administratës;

- Për vendosjen e përkohshme të panove reklamuese dhe të tabelave të shpalljeve në vendet publike krasas kërkesës duhet ti bashkëngjitet edhe skica ose projekt me

përshkrimet teknike, i cili përmban shënimet mbi madhësinë dhe vendet ku do të vendoset dhe mbi periudhën kohore të vendosjes.

Gropat dhe pusetat në rrugë

Neni 91

91.1. Për sigurimin e kalimtarëve dhe të trafikut:

- a) Të gjitha gropat dhe pusetat e të ngjashme në rrugë, sheshe, oborre, bodrume, korridore dhe në vendet e ngjashme duhet të janë të mbyllura,
- b) Pusetat për ujësjellës dhe kanalizim, për kabllot elektrike dhe telefonike dhe të ngjashme gjithnjë duhet të ndërtohen dhe të mirëmbahen në gjendje të rregullt.

91.2. Për mirëmbajtjen e gropave, pusetave etj. nga alineja paraprake pika a) janë të obliguar që të kujdesen pronarët, respektivisht shfrytëzuesit e pasurive të paluajtshme, të cilëve u shërbejnë, ndërsa për gropat nga pika b) e këtij neni, janë të detyruara të kujdesen ndërmarrjet të cilat e ushtrojnë atë veprimitari.

Neni 92

92.1. Gropat dhe pusetat e të ngjashme të përfshira me këtë Rregullore duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të mbahen të mbyllura me mbulesë adekuate të sigurt.

92.2. Gjatë kohës së përdorimit gropat duhet patjetër të rrëthohen dhe të shënohen me shenjë që shihet mirë dhe sipas nevojës, të mbyllen mirë që të mos e pengojnë sigurimin e kalimtarëve ose trafikut.

Terrenet sportive

Neni 93

Terrenet dhe fushat e sportit janë sipërfaqe publike të lira ku mbahen manifestimet sportive me qëllim të organizimit të garave dhe të argëtimit.

Neni 94

Terrenet sportive dhe objektet sportive nuk mund të shfrytëzohen pa lejen paraprake të titullarit.

Neni 95

Ndalohet:

- 95.1. Kapërcimi i rrëthojave të terreneve sportive dhe të qendrës sportive rekreative.
- 95.2. Hipja ose mbështetja në rrëthojat e terreneve sportive dhe të qendrave sportive dhe rekreative.
- 95.3. Kullotja e bagëtisë në terrenet sportive dhe terrenet tjera sportive rekreative.
- 95.4. Të gjitha veprimet tjera me të cilat dëmtohen terrenet sportive dhe qendrat sportive e rekreative.

Neni 96

96.1. Terrenet për sport dhe argëtim (stadiumi, qendra sportive-rekreative, fushat e sportit dhe hapësirat e objektet e ngjashme) duhet të mirëmbahen dhe pastrohen rregullisht, për të cilat kujdesen organet, personat juridik dhe individët të cilët këto objekte i shfrytëzojnë dhe i mirëmbajnë.

96.2. Në hapësirat dhe objektet nga alineja paraprake duhet që në vend të dukshëm të vendosen në formë të shkruar udhëzimet higjenike dhe teknike mbi punë në këto hapësira dhe terrene.

96.3. Vizitorët janë të obliguar që tu përbahen udhëzimeve dhe dispozitave nga alineja paraprake.

Shënim i rrugëve dhe i ndërtesave

Neni 97

97.1. Të gjitha rrugët duhet të kenë të shënuar, në këndet e tyre, tabelat me emërtimin e rrugëve, ndërsa ndërtesat dhe shtëpitë duhet të kenë numrat e tyre.

97.2. Shënimet me emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave tjera publike, si dhe shënimet e ndërtesave, shtëpive dhe të trojeve bëhen nga ana e organit kompetent komunal.

97.3. Shpenzimet sipas alinesë 1 dhe 2 të këtij nenit bien në barrë të Komunës.

Neni 98

Organi i administratës kompetent për punë komunale mban evidencën mbi rrugët, emërtimin e tyre dhe numrat e shtëpive dhe kryen ndërrimin me kohë të evidencave të nevojshme.

Neni 99

Organi përkatës i administratës komunale do të jap formën, madhësinë dhe ngjyrën e tabelave për shënimin dhe emërtimin e rrugëve dhe të shesheve, të tabelave me numër të shtëpive, do të caktoj mënyrën e shënimit dhe do të ketë evidencën në pajtim me nenin paraprak.

Objektet publike dhe higjenike

Neni 100

Të gjitha ndërtesat, objektet hoteliere (hotelet, motelet, autokampet) objektet përmbarëvajtjen e shfaqjeve, ligjëratave, hapësirat e klubeve, stacionet e autobusëve, stacionet hekurudhore dhe objektet tjera të ngjashme, duhet patjetër të kenë më shumë nyje sanitare të ndërtuara në pajtim me dispozitat dhe kushtet higjeniko-teknike.

Neni 101

101.1. Nyjet sanitare në ndërtesat e kinemave, teatrove, lokaleve të klubeve, stacioneve hekurudhore, në objektet hoteliere, nëpër punëtori me prodhime jetësore-ushqimore, në terrenet sportive, nyjet sanitare publike në vendet tjera publike duhet të janë të gëlqerosura dhe këtë duhet bërë çdo 30 ditë, nëse nuk janë të ngjyrosura me ngjyra të yndyrshme ose nuk janë me pllaka qeramike ose prej materialit të ngjashëm.

101.2. Dezinfektimi i nyjeve sanitare në objektet hoteliere, në kinema, spitale dhe nyje sanitare publike, bëhet për çdo ditë, ndërsa në objektet tjera çdo 7 ditë.

101.3. Gjatë verës, nyjet sanitare sipas alinesë paraprake, çdo 7 ditë duhet të spërkaten me mjete dezinfektuese.

Neni 102

102.1. Gropat septike duhet të gjenden jashtë ndërtesave dhe duhet të janë të larguara nga muri i jashtëm i ndërtesës dhe të ndërtesës fqinjë më së paku 2 m.

102.2. Gropat septike mund të ndërtohen nga çimentoja, guri ose tullat dhe duhet të janë patjetër të lyera me mallter çimentoje dhe të izoluara.

102.3. Gropat pa tjetër duhet të janë të mbyllura hermetikisht me pllakë betoni, guri ose metali.

102.4. Gropat septike nuk mund të ndërtohen në trotuare dhe në sipërfaqe tjera publike.

102.5. Lejen për ndërtim e jep organi i administratës kompetente për urbanizëm në bazë të pëlqimit të inspektorit sanitar.

Neni 103

Organ i administratës për punët e inspektimit mund të caktojë me vendim, mënjanimin e nyjes sanitare dhe të gropës septike dhe jep urdhër që të ndërtohet e reja, nëse ajo nuk është ndërtuar sipas kushteve të parapara të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe për këtë shkak paraqesin rrezik për rrëthinen në pikëpamje shëndetësore higjenike.

Gropimi i sipërfaqeve publike

Neni 104

104.1. Ndalohet çdo gropim dhe çdo dëmtim i sipërfaqeve publike, me përjashtim përrastet e parapara me këtë rregullore.

104.2. Qytetarët dhe personat civilo - juridik nuk mund të bëjnë gropim e sipërfaqeve publike.

104.3. Sipërfaqet mund të gropohen, në bazë të lejes së organit kompetent administrativ, me rastin e vendosjes së rrjetave të reja të ujësjellësit, të kanalizimit, të rrjetit telegrafik, të objekteve të sinjalizimit në trafik, pastaj lidhur me ndërlidhjen e ndërtesave dhe objekteve të tjera për këto rrjeta si dhe për mirëmbajtjen e instalimeve të këtyre objekteve (në tekstin e mëtejmë pajisjet komunale).

Neni 105

105.1. Sipërfaqet publike, me lejen e organit kompetent, mund të rrëmihen edhe përvendosjen e objekteve të përherershme ose të përkohshme, siç janë: shtyllat, panot, reklamat, ormanët përvendosjen e pajisjeve të internetit, tabelat e shpalljeve e të ngjashme.

105.2. Objektet nga alineja paraprake mund të mbasin edhe pas skadimit të afatit për të cilin janë vendosur, nëse shërbejnë për zbulimin e qytetit dhe nëse për to merret leja nga organi kompetent i administratës.

Neni 106

Sipërfaqet e gropuara publike duhet menjëherë të meremetohen dhe të kthehen në gjendjen e mëparshme.

Neni 107

107.1. Evitimi i prishjeve në pajisjet komunale dhe gropimi i sipërfaqeve publike mund të bëhet nga ana e ndërmarrjeve të cilat kujdesen për këto pajisje dhe atë vetëm në raste kur kanë ngjarë prishjet dhe duhet urgjentisht të evitojen.

107.2. Në këtë rast ndërmarrja e cila e ka bërë gropiminështë e obliguar që menjëherë ose më së largu ditën e parë të punës ta njoftoj organin komunal kompetent për gropimin e sipërfaqes publike dhe njëkohësisht të kërkoj lejen për gropim.

107.3. Nëse organi kompetent vlerëson se evitimi i prishjes nga alineja 1 e këtij nenit, nuk ka qenë i natyrës urgjente, konsiderohet se punët e kryera janë bërë pa leje dhe kryesi i punëve i bartë të gjitha konsekuenca.

Neni 108

Gropimin e sipërfaqeve publike prej 1 m në perimetër përvieni e objekteve nga nenit 105 i kësaj rregulloreje, mund ta bëjë edhe organizata e cila i vendos ato objekte, ndërsa meremetimin do ta kryej vetë ose me anë të ndërmarrjes për mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Neni 109

109.1. Kérkesa pér dhënen e lejes pér gropimin e sipërfaqeve publike, duhet t'i përmbajë shënimet mbi llojin dhe sipërfaqen e bazës (shtresës) e cila duhet të rrëmihet, qëllimin e gropimit dhe vandin e saktë në të cilën do të bëhet gropimi, koha, fillimi dhe përfundimi i punëve etj.

109.2. Bashkë me kérkesën duhet të bashkëngjitet edhe situata (skica) e terrenit në shkallën 1:500 me terrenin e vizatuar, dhe sipërfaqen pér gropim, si dhe me pozitën e pajisjeve komunale në krahasim me pikat markante (të poshtme), si dhe thellësinë e gropimit.

Neni 110

110.1. Lejen pér gropimin e sipërfaqeve publike e jep organi kompetent pér punë Komunale.

110.2. Organi nga alineja paraprake nuk mund ta jap lejen pér gropim e sipërfaqeve publike në periudhën kohore prej 1 dhjetori deri më 28 shkurt.

110.3. Përjashtimisht, në rastet e nevojave urgjente mund të lejohet gropimi në periudhën kohore prej 1 dhjetorit deri më 28 shkurt.

110.4. Në vendimin pér lejimin e gropimit pa tjetër duhet të shënohet koha e fillimit të gropimit dhe e përfundimit të punëve në meremetimin e sipërfaqeve të gropuara.

110.5. Nëse punët pér shkak të gropimit të sipërfaqes publike nuk mund të kryhen në afatin e caktuar, investuesi është i obliguar që të kërkojë vazhdimin nga organi kompetent.

Neni 111

111.1. Gjatë gropimit të sipërfaqeve publike vendi ndërtimor duhet patjetër të sigurohet në mënyrë të theksuar me shenja, rrrethojë dhe masat tjera mbrojtëse në pajtim me dispozitat mbrojtëse në ndërtimtari.

111.2. Kryesi i punëve është i obliguar veçanërisht:

- a) që gropimin ta kryejë sipas lejes së dhënë;
- b) që vendi ndërtimor gjatë natës të jenë i ndriçuar;
- c) që vendin ndërtimor ta rregullojë ashtu që të mundësohet qarkullimi pa pengesë i automjeteve dhe i këmbësorëve;
- d) të shënohet dhe gjatë natës të ndriçohet vendi ku është lejuar, respektivisht ndaluar kalimi i automjeteve dhe këmbësorëve;
- e) punët të kryhen në pajtim me të gjitha kushtet teknike, të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugëve dhe të shesheve;

111.3. Pas kryerjes së punëve, vendi në të cilin është punuar, duhet të kthehet në gjendje të rregullt paraprake dhe të largohen të gjitha materialet nga vendi ndërtimor;

111.4. Ruga pér trafik, në raste të veçanta mund të groposen në tërë gjatësinë e saj nëse nuk mund të kryhen punët në mënyrë tjetër dhe atë natën në kohë prej 22:00 deri në ora 4:00 të ditës së ardhshme.

Neni 112

112.1. Baza e gropuar (sipërfaqja) duhet të kthehet në gjendje të mëparshme në mënyrën dhe afatin i cili është caktuar në vendim mbi lejen pér gropim.

112.2. Sipërfaqja e ndërtuar publike nuk guxon të shfrytëzohet pa lejen e organit kompetent.

Neni 113

Nëse bëhet gropimi i trotuarit, kryesi i punëve është i obliguar që me mjete përkatëse të siguroj kalimin mbi pjesën e groposur të rrugës.

Neni 114

Kryesi i punëve është i obliguar që të siguroj qasje pa pengesë në ndërtesat afariste dhe në lokale si dhe në ndërtesat banesore e objektet tjera.

Neni 115

115.1. Gjatë ndërtimit të rrugëve të reja ose rikonstruktimin e rrugëve ekzistuese, ndërmarrjet të cilat kujdesen për mirëmbajtjen dhe qeverisjen e pajisjeve komunale, si dhe qytetarët dhe organizatat të cilat në ato rrugë posedojnë objekte duhet të jen të njoftuara së paku 2 muaj para fillimit të ndërtimit, rikonstruktimit që të përgatitet për vendosjen e pajisjeve komunale ose për lidhjen e objekteve të veta në këto pajisje.

115.2. Qytetarët dhe subjektet tjera me të cilat kanë të bëjnë dispozitat e alinesë paraprake janë të obliguara që mbi nevojat e kryerjes së punëve në pajisjet komunale dhe në lidhjet që të njëjtë ta njoftojnë investitorin i cili punon ose rikonstrukton rrugën, në mënyrë që vendosja e lidhjeve të bëhet para ndërtimit ose rikonstruktimit të rrugës.

115.3. Rrugët e projektuara dhe të rikonstruktuara nuk mund të groposen para 3 vjetëve nga mbarimi i ndërtimit ose rikonstruktimi, përvëç në raste të parapara me ketë rregullore.

Neni 116

116.1. Investuesi është i obliguar që para marrjes së lejes për rikonstruktimin e sipërfaqeve publike ta deponoj depozitën bankare ne pajtim me rregullat e prokurimit) për evitimin e lëshimeve eventuale dhe meremetimin e sipërfaqeve publike.

116.2. Investuesi është i obliguar që para marrjes së lejes për rikonstruktimin e sipërfaqeve publike të siguroj nga kryesi i punës garacionin për cilësinë e punëve të kryera.

Neni 117

117.1. Nëse në afatin garantues prej 1 viti nga dita e kryerjes së punimeve në sipërfaqet e gropuara paraqiten dëmtime, meremetimin e bartë investitori me shpenzimet e veta.

117.2. Nëse investitori nuk i kryen meremetimet në bazë të alinesë më lartë, të njëjtat i kryen organi i administratës qe ka lëshuar lejen.

Pastrimi i qytetit

Neni 118

Në interes të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurimit të kushteve higjienike në qytet me rrëthinë dhe në paralagjet, rrugët, parqet, çerdhet e fëmijëve, oborret e ndërtesave familjare dhe afariste, trojet e lira dhe sipërfaqet tjera të hapura, si dhe të gjitha hapësirat e përbashkëta duhet patjetër të mirëmbahen në gjendje të pastër sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 119

Në mbajtjen e pastërtisë janë të detyruar të kujdesen qytetarët, ndërmarrjet, institucionet, organizatat, etj.

Neni 120

Lidhur me mbajtjen e pastërtisë në kuptim të dispozitave të kësaj rregulloreje, përfshihen këto objekte:

120.1. rrugët, trotuaret dhe sheshet;

120.2. parqet, shëtitoret, terrenet sportive dhe argëtuese;

120.3. stacionet e autobusëve dhe vendqëndrimet e autobusëve në vijat urbane dhe ndër-urbane;

- 120.4. ambulancat, spitalet dhe çerdhet e fëmijëve;
- 120.5. stacionet hekurudhore;
- 120.6. stacionet e karburantit;
- 120.7. varrezat;
- 120.8. tregjet;
- 120.9. shtrati i lumit dhe
- 120.10. hapësirat e hapura dhe të zbrazëta ndërmjet dhe rrëth banesave, si dhe toka ndërtimore e pa ndërtuar (trojet e zbrazëta).

Neni 121

- 121.1. Për mbajtjen e pastërtisë në stacionet e autobusëve, të karburanteve si dhe objektet hoteliere, autokampet dhe në vendet e ngjashme, janë përgjegjës ndërmarrjet punuese dhe subjektet të cilat e kanë të drejtën e shfrytëzimit të këtyre objekteve.
- 121.2. Shfrytëzuesit nga alineja 120.1 te kësaj rregulloreje janë të obliguar që në peronet, sallat e pritjes dhe në vendet tjera ku frekuentojnë njerëzit, në vendet e përshtatshme, të vendosin numër të mjaftueshëm të shportave për hedhjen e mbeturinave.
- 121.3. Nyjet sanitare publike duhet mbajtur në gjendje të rregullt dhe të pajisura me mjete të nevojshme si dhe të dezinfektohen kohë pas kohe me mjete përkatëse.
- 121.4. Nyjet sanitare publike pa tjetër duhet të jenë të hapura çdo ditë prej orës 5:00 deri në ora 24:00.

Neni 122

- 122.1. Për mirëmbajtjen e pastërtisë në sipërfaqe publike janë të obliguar që të kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e këtyre sipërfaqeve.
- 122.2. Pronarët dhe shfrytëzuesit e sipërfaqeve publike, punët mund t'ia besojnë ndërmarrjes së specializuar për mbajtjen e pastërtisë ne pajtim me procedurat e prokurimit.

Neni 123

- 123.1. Pronarët dhe shfrytëzuesit e sipërfaqeve publike janë të obliguar që ato ti mbajnë në gjendje të pastër.
- 123.2. Pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave banesore, të hapësirave afariste dhe trojeve të zbrazëta, janë të detyruar që ti pastrojnë trotuaret dhe sipërfaqet e tyre rrëth ndërtesave para trojeve.
- 123.3. Organi i administratës kompetent për punë kommunale para dhënies së lejes për shfrytëzimin e sipërfaqeve të lira publike nga subjekte të ndryshme do të sigurojë më parë dëshminë mbi taksën e paguar dhe obligimet tjera që kërkohen sipas ligjit e akteve nënligjore në fuqi.

Neni 124

Të gjitha oborret dhe korridoret e ndërtesave banesore duhet të jenë në gjendje të rregullt dhe të pastër. Për mirëmbajtjen e oborreve dhe korridoreve të ndërtesave banesore, kujdesen pronaret respektivisht shfrytëzuesit e atyre oborreve, korridoreve dhe bodrumeve.

Neni 125

Shfrytëzuesit e hapësirave afariste janë të obliguar që ato ti mbajnë të pastra. Xhamat nëpër dritare dhe vitrina duhet të jenë gjithmonë të pastër dhe në gjendje të rregullt.

Neni 126

- 126.1. Të gjithë banorët në vendet e banuara me karakter fshati apo vendbanimi, janë të obliguar që të kujdesen për mbajtjen e pastërtisë në vendet publike dhe sipërfaqet tjera.

126.2. Qytetarët e vendbanimeve të karakterit të fshatit janë të obliguar ti pastrojnë trotuaret respektivisht pjesët e rrugëve para shtëpive të veta, oborret dhe sipërfaqet tjera përpara dhe rreth shtëpisë.

126.3. Ndalohet:

- hedhja e mbeturinave dhe materialit tjeter fundrrinor në shtratin e lumenjve, përrojeve, në rrugë dhe në sipërfaqe tjera publike dhe kudo tjeter jashtë deponisë regjionale;
- hedhja e plehut të kafshëve në sipërfaqet jashtë oborreve të tyre;
- kanalet përcjellëse të ujit fundrrinor dhe të fekaleve të mos kalojnë nëpër rrugë, në sipërfaqe të e lira publike dhe në oborret e huaja;
- të mbyllen lëshesat, kanalet përcjellëse nëpër rrugët e rendit të IV dhe dëmtimet e ndryshme të këtyre pajisjeve;

Neni 127

127.1. Pastrimi i rrugëve duhet të bëhet sipas mënyrës dhe në kohën e cila e siguron efektin më të mirë të pastrimit dhe që në masën më të vogël pengon qarkullimin e kalimtarëve dhe zhvillimin normal të trafikut.

127.2. Ndalohet pastrimi i rrugëve në kohën prej orës 7:00 deri në ora 23:00, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

Neni 128

Larja e rrugëve mund të bëhet prej orës 24:00 deri në ora 5:00 të ditës vijuese.

Neni 129

129.1. Të gjitha automjetet tjera tërheqëse, para hyrjes në sipërfaqet publike të trafikut publik duhet patjetër të pastrohen nga balta dhe mbeturinat tjera.

129.2. Nga balta dhe papastërtia pa tjeter duhet pastrohen edhe të gjitha mjetet bartëse para daljes në sipërfaqe publike, në trafikun publik nga shkarkimet, nga objektet ndërtimore dhe nga hapësirat tjera nga të cilat balta dhe papastërtitë tjera mund të bartën në sipërfaqe publike.

Neni 130

130.1. Mjetet (qerret) tërheqëse mund të qëndrojnë, vetëm në vendin e caktuar për ato qëllime nga ndërmarrja publike që kujdeset për pastërtinë e qytetit në bashkëpunim me organet komunale.

130.2. Për mbajtjen e pastërtisë, në vendet sipas alinesë paraprake pronarët e mjeteve tërheqëse ia paguajnë kompensimin ndërmarrjes e cila kujdeset për mbajtjen e pastërtisë në këto vende. Ndalja dhe parkimi në trotuar, sheshet e vogla dhe rrugë i qerreve tërheqëse ndalohet rreptësisht.

Neni 131

131.1. Me qëllim të mbajtjes sa më të mirë të pastërtisë në sipërfaqe publike, vendosen shportat për mbeturina dhe kantat për mbeturina, në numër të mjaftueshëm dhe ato i sigurojnë shfrytëzuesit.

131.2. Për vendosjen, mirëmbajtjen dhe pastrimin e shportave dhe kantave, kujdeset ndërmarrja për mirëmbajtjen e higjenës publike.

131.3. Mënyrën vendin dhe numrin e kontinjerëve dhe të mjeteve tjera në sipërfaqe tjera publike e cakton organi përkatës nga Drejtoria e Shërbimeve Publike ne bashkëpunim me ndërmarrjen kontraktuese për bartjen e mbeturinave.

Neni 132

Bartja e mbeturinave bëhet ditën dhe natën. Gjatë bartjes së mbeturinave mjetet me të cilat ato barten duhet patjetër të janë të mbyllura ose të mbuluara, ashtu që të pengohet derdhja e tyre gjatë transportit në deponinë e caktuar.

Neni 133

133.1. Mbledhja e mbeturinave nga hapësirat banesore e afariste bëhet me anë të enëve speciale.

133.2. Vendi dhe mënyra e vendosjes së enëve speciale caktohet nga ana e Drejtorisë se Shërbimeve Publike ne bashkëpunim me ndërmarrjen kontraktuese për bartjen e mbeturinave.

Neni 134

134.1. Ndërmarrja dhe qytetarët janë të obliguar që me shpenzimet e veta të sigurojnë dhe të kenë numër përkatës të mjeteve, enëve speciale për mbledhjen e mbeturinave nga hapësira e tyre punuese dhe sipërfaqet e lira.

134.2. Sigurimin e enëve-mjeteve speciale nga kjo rregullore, obliguesit janë të detyruar që ta bëjnë në afat prej 1 muaji nga dita e hyrjes në fuqi të saj.

Neni 135

135.1. Mbeturinat dhe fundërrinat do të transportohen dhe gropohen në vendin i cili është i paraparë për këtë destinim (deponi), ndërsa fekalet transportohen në vendin e caktuar për to.

135.2. Deponimin dhe vendin e derdhjes së fekaleve e cakton Drejtoria e Shërbimeve Publike me mendimin paraprak nga inspektorati sanitari.

135.3. Për rregullimin e deponisë dhe të vendit për derdhjen e fekaleve, si dhe për mirëmbajtjen e tyre kujdeset ndërmarrja së cilës i besohen punët e pastrimit të qytetit.

135.4. Vendet në të cilat vendosen fekalet duhet patjetër të janë të rregulluara ashtu që fekalet të mos derdhen dhe të mos i shpërndan era.

Neni 136

136.1. Bartjen e mbeturinave nga enët e caktuara për mbeturina (enët speciale dhe kontejnerët) e kryen ndërmarrja së cilës i besohen punët e pastrimit.

136.2. Ndërmarrjes kontraktuese së cilës i janë besuar punët për mirëmbajtjen e higjienës së qytetit është e obliguar që ti përbahet plan programit të miratuar për pastrimin e qytetit sipas kontratës së punës.

136.3. Për çdo ndryshim në lidhje me planin dhe programin e pastrimit, ndërmarrja është e obliguar që t'i lajmërojë me kohë, në lidhje me ndryshimet, organet gjegjëse mbikëqyrëse.

136.4. Tarifën për lartësinë e kompensimit e cakton Bordi mbikëqyrës i ndërmarrjes.

Neni 137

137.1. Ndërtesat duhet të kenë nyjet sanitare higjienike. Nëse nuk kanë, pronarët e ndërtesës dhe të lokaleve afariste janë të obliguar që në afat prej 3 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje ti ndërtojnë nyjet sanitare përkatëse higjienike.

137.2. Ndërtimi i nyjeve sanitare higjienike dhe të gropave septike do të bëhet vetëm nëpër vende të përshtatshme. Vendet në të cilat do të ndërtohen duhet të caktohen nga ana e inspektorit dhe organit kompetent për punë kommunale.

Neni 138

Heqja e fekaleve nga gropat septike, nyjet sanitare dhe të ngjashme bëhet me anë të cisternave septike sipas rregullit gjatë natës prej orës 21:00 deri në ora 5:00 të mëngjesit.

Neni 139

Kryesit e punëve ndërtimore janë të obliguar që të kujdesen për:

- pastrimin e sipërfaqeve publike para vendeve ndërtimore deri te vendi i shkarkimit të materialit;
- derdhjen e materialit shkapërderdhës dhe gjatë rrënimit të pengohet pluhuri;
- deponimi dhe sigurimin e materialit ndërtimor nga rrënimi dhe bartjen e tij nga sipërfaqja publike.

Neni 140

Personat fizik dhe ata juridik të cilët bëjnë ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave ose të materialit para ndërtesave në rrugë ose trotuare janë të obliguar që menjëherë ti largojnë ato dhe ta pastrojnë vendin.

Pastrimi i borës

Neni 141

141.1. Për pastrimin e borës nga trotuaret dhe para ndërtesave afariste dhe banesore në pronësi shoqërore, kujdesen personat juridik të cilat i shfrytëzojnë ndërtesat afariste dhe këshillat shtëpiake, ndërsa për pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave familjare banesore dhe para hapësirave afariste (punëtoritë, lokalet afariste) kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave banesore dhe të hapësirave afariste.

141.2. Ndërmarrjet e ndryshme dhe qytetarët janë të obliguar që gjatë pastrimit të sipërfaqeve nga alineja 141.1 të këtij neni ta grumbullojnë borën dhe akullin në skaj të trotuarit, ndërsa ndërmarrja për mbajtjen e pastërtisë është e obliguar që borën e grumbulluar në skaje të trotuarit ta bart menjëherë jashtë qytetit e më së voni brenda 10 orësh.

141.3. Ndërmarrja për mbajtjen e pastërtisë, me rastin e reshjeve të mëdha atmosferike është e obliguar që nga rrugët, trotuaret, trafikut publik dhe atij të dorës së dytë të kujdeset dhe rregullisht ti pastrojnë ato nga bora dhe akulli si dhe të hedhin kripë mbi to.

Neni 142

Në rastet kur gjatë ditës bie borë, trotuaret sipas nevojës do të pastrohen edhe disa here në ditë dhe në rast se bora bie pandërprerë gjatë natës, e njëjtë do të pastrohet në ditën e ardhshme e më së voni deri në ora 9:00 të mëngjesit.

Mbajtja e pastërtisë dhe higjienës komunale në tregjet dhe në objektet e tregjeve

Neni 143

Për mbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës komunale nëpër tregje dhe objekte të tregjeve do të kujdeset pronari, respektivisht shfrytëzuesi i tregjeve.

Neni 144

Tregjet duhet të mbahen në gjendje të rregullt dhe të pastër. Çdo ditë tregjet pas kalimit të kohës së punës duhet të pastrohen mirë, lahen dhe të bihen në gjendje të rregullt.

Neni 145

Ndërmarrja për menaxhimin e tregjeve është e obliguar që në të gjitha tregjet të sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit të rregullt higjenik të pijshëm për freskimin e prodhimeve dhe pastrimin e tregjeve, si dhe të ndërtojnë numrin e caktuar dhe të nevojshëm të kabinave të nyjeve sanitare, të cilat duhet rregullisht të pastrohen dhe të mirëmbahen dhe të vihet numri i mjaftueshëm i enëve kontinjerëve për mbeturina dhe fundërrina, të cilat duhet të pastrohen rregullisht.

Neni 146

Ndalohet:

- 146.1. Pastrimi i tregut dhe i vendeve për shitje gjatë kohës së zgjatjes së afarizmit në treg.
- 146.2. Çdo shitje e mallit dhe e gjërave tjera ushqimore jashtë vendit të caktuar për këtë dhe ekspozimi i tyre para lokaleve afariste.
- 146.3. Shitia dhe ekspozimi i mallrave në vendet dhe hapësirat në afërsinë e tregut, e që do të pengonte qasjen dhe qarkullimin e lirë të blerësve, në hapësirat para tregut dhe në hyrje të drejtpërdrejtë të tregut, të cilat në çdo kohë duhet të jenë të lira për kalimtar blerës dhe trafikun e automjeteve dhe të mjeteve tjera.

Neni 147

Në hapësirat e tregut ku bëhet shitja e kafshëve, duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e ujit higjenik për pije dhe ujit për kafshë, si dhe të ndërtohen nyje sanitare me numër të caktuar të kabinave, të ndërtohen vendet për lidhjen e kafshëve dhe vendosen enët për grumbullimin e mbeturinave dhe të fundërrinave, ndërsa hapësira e tregut pas çdo dite të tregut duhet të pastrohet mirë nga plehu dhe nga fundërrinat tjera.

Neni 148

- 148.1. Hapësira e tregut për shitjen e materialit për ngrohje (dru, thëngjillit), si dhe asortimenteve tjera nga druri, për shitjen e gëlqeres dhe të prodhimeve të ngjashme duhet të mbahet në rregull, në gjendje të pastër dhe pas çdo dite të tregut pas kohës së punës të pastrohet.
- 148.2. Ndalohet shitja e prodhimeve të theksuara-materialit jashtë hapësirës së tregut të caktuar për këto destinime.

Neni 149

Në sipërfaqe publike ndalohet:

- 149.1. Hedhja e mbeturinave jashtë shportave për mbeturina dhe enëve për mbeturina, ose në mënyra tjera të krijohet papastërtia në sipërfaqe publike;
- 149.2. Prerja dhe copëtimi i druve, të grimcohet thëngjilli dhe materiali tjetër me përjashtim në placetë e zbrazëta, nëse për këtë ekziston leja për ndërtim të ndërtesave banesore dhe të tjera;
- 149.3. Larja e të gjitha mjeteve motorike, rrabave dhe lëndëve të tjera;
- 149.4. Meremetimi i automjeteve dhe kryerja e veprimitarive zejtare;
- 149.5. Lëvizja e automjeteve në të cilat është grumbulluar balta dhe papastërtia tjetër;
- 149.6. Lëvizja e automjeteve të cilat nuk janë siguruar nga materiali derdhës, i cili transportohet ose automjeteve të cilat mundësojnë përhapjen e gazrave gjatë transportimit (fekalet) dhe materialit tjetër me erë jo të këndshme, përvëç lëndës së asfaltit;
- 149.7. Lëshuarja dhe shpërndarja e ujit fundrrinor dhe të ndyrësirave tjera në sipërfaqe publike, në oborret fqinje dhe në korridoret e përbashkëta ose në ato sipërfaqe të hedhen si dhe të mbahen mbeturinat e të ngjashme;
- 149.8. Lëvizja e kafshëve dhe e shpezëve;
- 149.9. Kryerja e nevojës fiziologjike ;

- 149.10. Hapja e enëve me mbeturina (të enëve dhe të kontejnerëve);
 149.11. Prishja dhe marrja e lëndëve fundrrinore nga kantatë dhe kontejnerët;
 149.12. Ndezja e mbeturinave nëpër enë dhe në sipërfaqe publike;
 149.13. Hedhja në enët për mbeturina, si vijon: dheut, rërës, ambalazhit, mbeturinave nga kopshtet dhe mbeturinat e ngjashme;
 149.14. Zhvendosja e dyerve dhe mbulesave (kapakëve) nëpër enët për mbeturina;
 149.15. Zhvendosja e enëve për mbeturina nga vendet e caktuara, pa lejen e organit për punët komunale;
 149.16. Përdorimi i enëve për mbeturinat me vëllim mbi 120 l;
 149.17. Hedhja e mbeturinave dhe të fundërrinave të tjera jashtë enëve për mbeturina;
 149.18. Hedhja e thëngjillit jo të djegur, të hirit dhe të materialit tjetër ndezës nëpër enët për mbeturina (kontejner);
 149.19. Lëshimi i ujit nga krojet nëpër oborre, nëpër rrugë dhe nëpër oborret e huaja;
 149.20. Mbajtja e hidrantëve për ujë nëpër rrugë në gjendje jo të rregullt;
 149.21. Ndalimi i automjetit ose qerreve tërheqëse pranë enëve për mbeturina kontejnerëve, trotuareve, shesheve të vogla, sipërfaqeve të gjelbra, etj;
 149.22. Parkimi i të gjitha mjeteve motorike dhe të mjeteve tërheqëse nëpër trotuare;
 149.23. Vendosja e tavolinave, karrigeve, tezgave lëvizëse, ambalazhit, mallrave, bankomatëve, frigoriferëve, gjeneratorëve, ormaneve për internet, të objekteve reklamuese e të ngjashme;
 149.24. Mbajtja e papastërtisë në hapësirën ku bëhet pastrimi i veshmbathjes;
 149.25. Të mbahlen mbeturinat dhe fundërrinat nëpër enët të cilat nuk i plotësojnë kushtet për to;
 149.26. Në sipërfaqe publike, rrugë dhe trotuare të bëhet shtrirja e armaturës dhe lidhja për shtylla dhe rendin e drunjve për t'i drejtuar ato;
 149.27. Dalja nga vendi ndërtimor dhe nga sipërfaqet tjera të ngjashme me automjetet të ndotura në sipërfaqe publike të trafikut publik.

Neni 150

- 150.1. Në territorin e qytetit dhe në paralagjet ndalohet:
 150.1.1. Nxjerra e materialit ndërtimor, eksploatimi i fraksioneve të gurit nga prerjet e tullave skaj rrugëve publike e të ngjashme;
 150.1.2. Lëshimi ose përcjellja e ujit fekal nga gropat e nyjeve sanitare, si dhe mbeturinat e gropave septike nëpër kopshte, kanale, lumenj, në rrugë dhe në oborre fqinje;
 150.1.3. Të hedhen dhe të derdhen nëpër oborre ose para hapësirave të ndërtesave banesore mbeturinat, fekalet, uji si dhe në çfarëdo mënyre të dëmtohen kushtet higjenike të qytetarëve të tjerë ose të banuesve;
 150.1.4. Tu jepet ujë kafshëve nëpër krojet publike;
 150.1.5. Të hedhen dhe të mbulohen kafshët dhe shpezët e ngordhura jashtë varrezave të destinuara për kafshë;
 150.1.6. Të braktisen dhe të lidhen mjetet tërheqëse në vendet në të cilat nuk janë caktuar për këto qëllime;
 150.1.7. Të bëhet prodhimi me dorë i tjegullave dhe tullave si dhe i gëlqeres.

Neni 151

Në gjithë territorin e Komunës rreptësisht ndalohet:

- Djegia e hamullorëve, gomave, vajrave motorike, plastikës, pesticideve, barnave dhe të gjitha mbeturinave tjera tokësike;
- Hedhja në sipërfaqe të tokës, ujit dhe kanalizimeve e vajrave motorike, pesticideve, barnave dhe substancave tjera tokësike.

Neni 152

Për shërbimet të cilat ndërmarrjes i besohen punët për pastrimin e rrugëve të shtruara largimit të borës dhe të akullit, transportimin dhe deponimin e tyre në sipërfaqet në pajtim me këtë rregullore, i takon kompensimi në lartësinë dhe në kushtet të cilat përcaktohen me kontratë dhe me tarifën e lejuar.

Neni 153

153.1. Inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë ka të drejtë që ta ndalë automjetin i cili transporton mallra, material ndërtimor, material fundrrinor, drunj, thëngjill etj.

153.2. Ndalimin e automjeteve në fjalë inspektori e bënë me paraqitjen e shenjës për komunikacion "Ndalohet trafiku në të dy drejtimet", në të cilin është shkruar "STOP INSPEKTORATI", vozitësit e automjeteve janë të obliguar që ti ndalin automjetet në këtë shenjë dhe duhet ti ofrojnë shënimet që kërkohen nga inspektorët.

153.3. Ndalimi i automjeteve nga alineja 2 e këtij neni nuk guxon të kryhet nëpër vende ku do të bëhet rrezikimi i sigurisë në trafik.

Furnizimi i lagjeve me energji termike

Neni 154

154.1. Me furnizim të lagjeve me energji ngrohëse nënkuftohet ndërtimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i rrjetës unike termike, të qytetit në lagje dhe blloqe, të cilat, rikonstruktohen dhe ndërtohen në territorin e qytetit dhe vendbanimeve pran qytetit.

154.2. Ndërtimi i sistemit dhe i objekteve të rrjetit termik të qytetit dhe të vendbanimeve afér qytetit përcaktohet me planin rregullues urbanistik.

Neni 155

155.1. Në blloqet banuese e të tjera që do të ndërtohen e të cilat janë të përfshira me planin e ngrohjes nga parografi paraprak, duhet të përfshihen dhe të ndërtohen e montohen instalimet e ngrohjes qendrore, me lidhje në rrjetin unik termik të qytetit, në lagje ose në bllok sipas planit urbanistik ose me vendim të Komunës, për disa lagje dhe blloqe nuk është caktuar ndryshe.

155.2. Në objektet, nga parografi paraprak në të cilat duhet të ndërtohen dhe montohen instalimet e ngrohjes qendrore me lidhjen në rrjetin unik termik të qytetit në lagje ose në bllok nuk mund të parashihet dhe të ndërtohen kazana për disa objekte nëse ndërmarrja, së cilës i janë besuar punët e ngrohjes së qytetit, garanton që me ditën e marrjes së lejes për përdorim të objektit do të mundësojë shfrytëzimin e ngrohjes përpos objekteve të destinimit të veçantë nëse ndërmarrja përfshira me furnizim me energji ngrohëse nuk i siguron kushte përlidhje.

Neni 156

Pronarët e ndërtesave të banimit në sektorin privat të cilët posedojnë ngrohje qendrore ose ngrohje etazhi janë të detyrueshëm të lidhen në rrjetin termik publik, në afat prej një viti prej ditës së ekzistimit të mundësisë teknike përlidhje në rrjetin termik. Shfrytëzuesi i ngrohjes qendrore nuk mund ta ndërroj mënyrën e ngrohjes së lokaleve.

Neni 157

157.1. Financimi dhe ndërtimi i rrjetit unik termik të qytetit kryhet përmes të ndërmarrjes që merret me ngrohjen e qytetit, e në bazë të planit të ngrohjes së qytetit.

157.2. Kompensimi për ngrohje të lokaleve me energji termike nga ngrohja e qytetit paguhet sipas m^2 të sipërfaqes shfrytëzuese.

Neni 158

158.1. Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e ndërtimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të tërësishëm dhe të stabilimenteve për ngrohjen e qytetit është e detyruar që tërë sistemin ta mirëmbajë në mënyrë permanente në gjendje të rregullt dhe eksploatuse.

158.2. Ndërmarrja nga paragrafi paraprak është e detyruar që konsumatorit të energjisë termike ti sigurojë në mënyrë permanente energjinë e projektuar termike nga sistemi unik termik i qytetit.

Neni 159

159.1. Ndërmarrja e cila furnizon qytetin me energji termike është e obliguar që të fillojë të bëjë ngrohjen e objekteve gjatë periudhës prej 15 tetorit e deri në 15 prill të vitit tjetër.

159.2. Përjashtimisht, jashtë kësaj periudhe objektet mund të ngrohen nëse temperatura e jashtme është më e ulët se 14 gradë celsius në orën 13:00 tri ditë rresht.

Neni 160

160.1. Ndërmarrja nga neni paraprak është e detyruar që gjatë periudhës së ngrohjes të sigurojë temperaturën e ngrohjes së ujit prej minimum 90 gradë celsius në nënstacionet e objekteve me ç'rast fitohet temperatura e nevojshme lokale.

160.2. Po qe se në banesë ose lokalet tjera nuk sigurohet temperatura e nevojshme (prej 22°C), organizata është e detyruar që ti mundësoj shfrytëzuesit të banesës ose të lokaleve të tjera që mundet të shqoje numër të nevojshëm trupash për ngrohje, në mënyrë që të mundet të sigurohet temperatura e dëshiruar. Këto punime kryhen sipas rregullit jashtë periudhës së ngrohjes.

Neni 161

Ndalohet:

- a) Lidhja në rrjetën primare të largpërcuesit termik, pa lejen paraprake të organit kompetent të administratës, e pas pëlqimit paraprak të marrë nga ndërmarrja të cilës i janë besuar punimet e ngrohjes;
- b) Dëmtimi i rrjetit primarë të ngrohjes (në pusetat, termo, nënstacionet dhe në stabilimente të pompave).

III. MBIKËQYRJA

Neni 162

Mbikëqyrjen e zbatimit dhe respektimit të dispozitave të kësaj rregulloreje e kryejnë organet komunale të administratës si Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje te Mjedisit dhe Drejtoria e Inspektive.

IV. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 163

163.1. Me dënim në shumën prej 250€ deri 850€ do të ndëshkohen ndërmarrjet e autorizuara për mbajtjen e pastërtisë, higjenës komunale dhe gjelbërimit, ndërmarrjet punuese, shkollat ose personat e tjerë juridik nëse nuk u përbahen dispozitave dhe masave nga këto nene:

163.1.1. Nëse nuk e kryejnë pastrimin e të gjithë mbledhësve të ujit dhe të pusetave për ujin atmosferik më së paku dy herë në vit (neni 5 alineja 5);

163.1.2. Nëse nuk ua sigurojnë konsumuesve sasinë e mjaftueshme të ujit higjenik dhe të rregullt (neni 8);

- 163.1.3. Nëse nuk e pengon çdo derdhje të tepër të ujit (neni 30);
- 163.1.4. Nëse nuk e kryen pastrimin e rregullt të mbledhësve të ujit dhe të pusetave për kanalizimin atmosferik dhe atë fekal, në mënyrë që çdo kohë të mund të përgjigjet destinimit të vet (neni 33);
- 163.1.5. Pas kryerjes së punëve të ujësjellësit dhe të kanalizimit të cilat ajo i kryen dhe nuk e bie terrenin në gjendje të mëparshme të rregullt (neni 34 paragrafi 1);
- 163.1.6. Nëse nga rrugët, trotuaret, dhe sipërfaqet publike nuk e largon materialin e tepërt në afatin e paraparë me vendimin nga ana e organit kompetent (neni 35);
- 163.1.7. Nëse i shfrytëzojnë sipërfaqet e gjelbërtë jashtë suazave të tyre pa lejen e organit kompetent (neni 46);
- 163.1.8. Nëse nuk i eviton dëmet në rrugët e trafikut, trotuaret si dhe nëse tereni nuk e bie në gjendjen e mëparshme të rregullt (neni 56);
- 163.1.9. Nëse gjatë shfrytëzimit të trotuarit, rrugës dhe sipërfaqes tjetër publike vie deri te dëmtimi i tyre (neni 61);
- 163.1.10. Nëse kryen ndonjë veprim të ndaluar të paraparë (nenin 69);
- 163.1.11. Nëse nuk vepron në pajtim me nenin 71;
- 163.1.12. Nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara të nenit 78 dhe 79;
- 163.1.13. Nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara me nenin 81;
- 163.1.14. Nëse nuk e kryen aranzhimin profesional të artikujve nëpër vitrina, nuk i shkruan çmimet e artikujve me material të njëjtë, nuk e shpallë me shkrim orarin e punës fillimin dhe mbarimin e punës (neni 84);
- 163.1.15. Nëse vërtetohet nga ana e organit kompetent dhe vlerëson se rrëmihja dhe evitimi i prishjes nga neni 110 alineja 1 nuk ka qenë i natyrës urgjente (neni 110);
- 163.1.16. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 112;
- 163.1.17. Nëse me rastin kur bie bora nuk vepron në mënyrën e paraparë me nenin 141 alineja 1,2 dhe 3.
- 163.2. Për kundërvajtje nga neni 5 deri 22 dhe neni 30, 33, 34, 35, 46, 56, 61, 69, 71, 81, 87, 110, 112, 141, dhe 151 të kësaj rregulloreje do të dënohen me të holla (dënim mandator) në shumën prej 100 € edhe personi përgjegjës në ndërmarrjen e autorizuar për mirëmbajtjen e higjenës komunale dhe gjelbërimit, ndërmarrjen punuese, organin shtetëror, organizatën, shkollën apo personin tjetër juridik nëse deri te kundërvajtja ka ardhur me veprimin apo mosveprimin e tij.

Neni 164

- 164.1. Me dënim në shumë prej 150 € deri 750 € do të ndëshkohet për kundërvajtje ndërmarrja për mbajtjen e pastërtisë, higjenës komunale dhe gjelbërimit, ndërmarrja punuese, organizata, organi shtetëror, shkollat dhe personi tjetër juridik, nëse nuk u përbahet masave të përcaktuara me këto nene:
- 164.1.1. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 11 dhe 12;
- 164.1.2. Për shkak të lidhjes me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit pa leje (neni 17);
- 164.1.3. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 22 dhe 36;
- 164.1.4. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga nenet 47, 48, 49, 50, 52, 53, 57, 60;
- 164.1.5. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga nenet 70,72,73,75,76;
- 164.1.6. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 80 alineja 1,2 dhe 3 dhe neni 82;
- 164.1.7. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 66 alineja 1 dhe 2;
- 164.1.8. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 86,88 dhe 90;
- 164.1.9. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 94, 95 alineja 1,2,3 dhe 4;
- 164.1.10. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 96;
- 164.1.11. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 119;
- 164.1.12. Nëse nuk u përbahet masave të përcaktuara nga nenet 111,112,113,114 dhe 117;

- 164.1.13. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e parapara nga neni 123;
- 164.1.14. Nëse nuk sillet në pajtim me nenin 124 dhe 125;
- 164.1.15. Nëse nuk e bënë shpëlarjen e rrugëve dhe pastrimin në pajtim me kontratën në mes të organeve përkatëse të administratës komunale dhe ndërmarrjes punuese kompetente (neni 130,131);
- 164.1.16. Nëse nuk e siguron numrin e mjaftueshëm të enëve speciale dhe kontejnerëve për grumbullimin e mbeturinave nga të gjitha hapësirat punuese dhe sipërfaqet e lira (neni 134);
- 164.1.17. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 136 dhe 137;
- 164.1.18. Nëse nuk e bënë pastrimin e sipërfaqeve publike para vendeve ndërtimore, nëse nuk e spërkatë materialin e grimcuar gjatë rrënimit në mënyrë që mos të ngjitet pluhuri Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 139;
- 164.1.19. Nëse nuk i përbahet masave të përcaktuara nga neni 140;
- 164.1.20. Nëse kur bie bora nuk vepron në mënyrën e paraparë me nenin 141 dhe 142;
- 164.1.21. Nëse nuk u përbahet masave të përcaktuara nga nenet 143,144,145, 146, 147, 148 dhe 149;
- 164.1.22. Nëse nuk i respekton nenet 150, 151 dhe 152;
- 164.1.23. Nëse gjatë paraqitjes së shenjës së komunikacionit "STOP-INSPEKTORATI" vozitësit e automjeteve të rënda nuk i ndalin dhe nuk i ofrojnë shënimet e kërkua inspektorit (neni 153).
- 164.2. Për kundërvajtje nga neni 164 të pikës 11,12,13,14,15,16,17,19,20,21,22, dhe 23 do të dënohen me të holla (dënim mandator) në shumën prej 100€ edhe personi përgjegjës në ndërmarrjen e autorizuar për mirëmbajtjen e higjienës komunale dhe personat tjerë përgjegjës, nëse deri te kundërvajtja ka ardhur me veprimin apo mosveprimin e tyre.

Neni 165

- 165.1. Me dënim në të holla në shumë prej 100 € deri 500 € do të dënohet për kundërvajtje qytetari - personi dhe pronari i punëtorisë zejtare i cili merret me veprimitari ekonomike ose me veprimitari zejtare, nëse nuk u përbahet masave të përcaktuara nga këto pika:
- 165.1.1. Nëse pa lejen përkatëse bënë kyçje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit (neni 17);
- 165.1.2. Nëse bënë ndonjërin prej veprimeve të ndaluara nga neni 36 alineja 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, dhe 8;
- 165.1.3. Nëse bënë ndonjërin prej veprimeve nga neni 53 alineja 1 deri 18;
- 165.1.4. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 61;
- 165.1.5. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 62 alineja 3, 4 dhe 5;
- 165.1.6. Nëse nuk u përbahet masave të përcaktuara nga neni 70 deri 77;
- 165.1.7. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 78, 79, dhe 80;
- 165.1.8. Nëse nuk vepron sipas vendimit të Drejtorisë për Inspektore, respektivisht nëse nuk i eviton mungesat në afatin e caktuar (neni 81);
- 165.1.9. Nëse nuk e eviton rrezikun nga rrënimi i objekteve i cili është rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, të objekteve fqinjë dhe sigurinë në trafik (neni 82);
- 165.1.10. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e (neneve 86, 87, 88 dhe 89);
- 165.1.11. Nëse bënë ndonjërin prej veprimitarive të ndaluara nga neni 95;
- 165.1.12. Nëse nuk e bënë dezinfektimin e nyjeve sanitare dhe gëlqerosjen e tyre të paraparë me nenen 101;
- 165.1.13. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 104;
- 165.1.14. Nëse nuk u përbahet masave të caktuara nga nenet 111, 112, 113, 114 dhe 117;
- 165.1.15. Nëse bënë ndonjërin prej veprimeve me të cilin nuk respektohet neni 126;
- 165.1.16. Nëse nuk u përbahet masave të përcaktuara nga neni 141;
- 165.1.17. Nëse nuk respektohet neni 146;

165.1.18. Nëse bënë ndonjërën prej veprimeve të ndaluara nga neni 149 nga pika 1 deri në pikën 27;

165.1.19. Nëse gjatë paraqitjes së shenjës së komunikacionit nga ana e inspektorit komunal në "STOP-INSPEKTORI" vozitësit e automjeteve të rënda nuk ndalen dhe nuk i ofrojnë shënimet e kërkova nga inspektori (neni 153).

Neni 166

166.1. Me dënimin në të holla në shumë prej 150 deri 500 € do të dënohen për kundërvajtje qytetari, individi dhe pronari i punëtorisë zetare i cili merret me ekonominë e pavarur ose me veprimtarinë zetare nëse nuk u përbahet dispozitave dhe masave të përcaktuara nga këto pika:

166.1.1. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 35;

166.1.2. Nëse i shfrytëzon sipërfaqet publike të gjelbra jashtë destinimeve të tyre themelore pa leje nga organi kompetent (neni 46);

166.1.3. Nëse bënë ndonjérin nga veprimet e ndaluara nga neni 57 alineja 1 dhe 2;

166.1.4. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 60;

166.1.5. Nëse bënë ndonjérin prej veprimeve të ndaluara nga neni 70 alineja 1 dhe 2;

166.1.6. Nëse nuk u përbahet masave të përcaktuara nga neni 78;

166.1.7. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 81 dhe 82;

166.1.8. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 93;

166.1.9. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 94 dhe neni 95;

166.1.10. Nëse nuk e bie terrenin në gjendje të mëparshme të rregullt në sipërfaqen e rrëmihur të paraparë sipas nenit 111;

166.1.11. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 122, 123 dhe 126;

166.1.12. Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 129, 130 dhe 134;

166.1.13. Nëse nuk u përbahet masave të përcaktuara nga neni 140;

166.1.14. Nëse nuk u përbahet masave të përcaktuara nga neni 146;

166.1.15. Nëse bënë ndonjérin prej veprimeve të ndaluara nga neni 150 pika 1 deri në 7.

Neni 167

Për kundërvajtjet e caktuara me këtë rregullore, të cilat i bëjnë jo madhorët, të rinjtë, atëherë me gjobë do to dënohen prindërit e tyre respektivisht kujdestarët.

Neni 168

Për kundërvajtjet nga nenet: 36, 53, 59, 69, 87, 88, 103, 104, 105, 121, 122, 123, 124, 126, 127, 128, 129, 144, 145, 146, 147, 149, 150, 151 dhe 153, inspektorët komunal kanë autorizime të shqiptojnë dënimë (gjoba) mandatore, në shumë prej 50 € për individët dhe personin përgjegjës, kurse personin juridik dhe individin në kryerjen e veprimtarisë së pavarur 100 €.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 169

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Inspektime dhe ndërmarrjet publike regionale- njësítë operative në Vushtrri si dhe Policia.

Hyrja në fuqi


Neni 170

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 171

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja mbi shërbimet komunale dhe rregullimin e qytetit 01Nr.731/04, dt. 29.09.2004.

Kryesuesi i Kuvendit


Habib Mustafa

